



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 516 Akti

Nr. 622 Vendimi
Tiranë, më 13.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 9.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Arta Llazari**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arta Llazari do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 19.6.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arta Llazari, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 22.7.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar¹ mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 20.1.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arta Llazari për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 31.1.2023 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Po në datën 20.1.2023 subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 11 ditëve. Në datën 31.1.2023 subjekti paraqiti kërkesë për shtyrje të afatit të dërgimit të shpjegimeve të saj. Komisioni, pasi shqyrtoi shkaqet e parashtruara në kërkesën e subjektit, dhe specifikisht: (a) materiali i rezultateve të hetimit ka qenë voluminoz; (b) pamundësi kohore nga ana e saj, pasi ka qenë gjyqtare e gatshme për të gjitha kërkesat me karakter të ngutshëm që paraqiten tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nga data 22 deri në 31 janar, duke depozituar edhe dokumentacion² - vendosi ta pranojë atë, duke caktuar një afat të ri për dërgimin e shpjegimeve deri në datën 6.2.2023, duke e njoftuar edhe subjektin po në të njëjtën datë. Në datën 6.2.2023 subjekti dërgoi në mënyrë elektronike shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

¹Referohuni deklaratës së subjektit të depozituar në rrugë zyrtare në datën 26.10.2022.

²Urdhri nr. ***, datë 28.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Për përcaktimin e gjyqtarëve për periudhën 1.1.2023 – 31.1.2023.

8. Trupi gjykues, në datën 7.2.2023, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Arta Llazari në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 7.2.2023 subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 9.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Arta Llazari u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arta Llazari. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 9.2.2023, për të rifilluar më 13.2.2023, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Arta Llazari ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas kërësive IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese³ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

³Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar nr. *** prot., datë 2.8.2018, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arta Llazari, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ku më parë subjekti, në datën 24.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 24.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament me sipërfaqe 71 m², i ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Shkodër. Privatizimi i banesës sipas ligjit nr. 7552, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, nga dy prindërit e saj K dhe A. Ll. Pas rivlerësimit në datën 1.2.2012, ky apartament është vlerësuar në masën 3.042.882 lekë, në bashkëpronësi në tërësi nga 1/3 secili. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴.

⁴Informacion mbi pasurinë lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër, me nr. *** prot., datë 26.10.2016, i cili informon se në emër të shtetasve Arta, K dhe A.LL është e regjistruar pasuria apartament me sip. 71 m², me nr. ***; certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.10.2005, për pasurinë e llojit “apartament” me sip. 71 m², me nr. ***, regjistruar në emër të shtetasve K., A. dhe Arta Llazari; hartë treguese e regjistrimit; kartelë e pasurisë së paluajtshme, në të cilën evidentohet se në datën 1.2.2012 apartamenti me sip. 71 m² është rivlerësuar në vlerën 3.042.882 lekë (aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së).

17.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se subjekti, në deklaratën e pasurisë *Vetting*, nuk ka deklaruar: (i) blerjen dhe burimin financiar të pjesës takuese nga vëllai i subjektit të lidhur me apartamentin me sip. 73 m² në Shkodër, të përfituar nga privatizimi i banesave kundrejt çmimit 1.000.000 lekë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2005; (ii) shtesën e banesës në Shkodër, vlerën e investimit dhe burimin e krijimit, si në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *Vetting*, rrjedhimisht burimi i krijimit të shtesës mbetet i paqartë.

Hetimi i Komisionit

17.2 Subjekti rivlerësimi e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2003, me përshkrimin “Shtëpi banimi, hyrje pallati 2+1 me sip. 72 m², me adresë lagjja ‘***’, rr. ‘***’, p. ‘***’, kati i ‘***’, Shkodër”. Pjesa që zotëron në këtë pasuri është 25%. Burimi i krijimit: privatizimi i banesave shtetërore me kontribut vullnetar i vitit 1992.

17.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 subjekti ka deklaruar ndryshimet e ndodhura në pjesën takuese për këtë pasuri. Më konkretisht ka deklaruar: “*Apartament banimi, zona kadastrale ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, sipërfaqe totale 73 m². Fillimisht e privatizuar në '93-in, më pas blerë pjesa e njërit prej bashkëpronarëve për vlerën 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 1/3*”. Në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pjesës së saj takuese.

17.4 ASHK Drejtoria Vendore Shkodër⁵ konfirmon regjistrimin e pasurisë e llojit “apartament” me sip. 73 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e fituar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.9.2005, në bashkëpronësi të shtetasve K., A. dhe Arta Llazari.

17.4.1 Kjo drejtori ka bashkëlidhur edhe praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie, ku janë përfshirë të gjitha transaksionet nga origjina e pronësisë dhe mënyra e fitimit të saj deri tek pronari i ligjshëm aktual (sipas transaksionit të fundit aktiv në kartelën e pasurisë së paluajtshme). Kjo pasuri është përfituar me kontratën e privatizimit të banesave shtetërore, nënshkruar në datën 8.6.1993⁶ nga shtetasi K.LL, në vlerën 18.860 lekë dhe më pas është nënshkruar akti i shitblerjes nr. ***, datë 29.9.1994, e pasurisë së paluajtshme apartament banimi, me palë shitëse Ndërmarrja e Banësive Shtetërore Shkodër dhe palë blerëse shtetasit K.LL, A.LL, B.LL dhe Arta Llazari.

17.4.2 Nga verifikimi i kartelës së pasurisë, konstatohet se: (i) në datën 4.3.2005 është bërë korigjimi i sipërfaqes së apartamentit nga ZVRPP-ja Shkodër, nga 71 m² në 73 m², e cila e ka saktësuar atë dhe për këtë arsye vihet re ndryshimi në sipërfaqe për këtë pasuri në dokumentet ligjore të lëshuara pas kësaj date; (ii) në datën 14.10.2005 është bërë regjistrimi në ZVRPP-në Shkodër i kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2005.

Trupit gjykues nga ky regjistrim i rezultoi se kjo kontratë kishte për objekt tjetërsimin e pjesës takuese të njërit prej bashkëpronarëve, konkretisht shtetasi B.LL, në ¼ pjesë takuese në cilësinë e shitësit dhe kalimin në pronësi të kësaj pjese tek bashkëpronarët e tjerë Arta, A. dhe K.LL. Çmimi i shitjes i ¼ pjesë reale të pronësisë në kontratë është caktuar 1.000.000 lekë dhe kjo shumë, siç është shprehur edhe në kontratë, është likuiduar plotësisht mes palëve jashtë zyrës noteriale. Nga hetimi i gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të praktikës së regjistrimit në seksionin “përshkrimi i veçantë” të kartelës së pasurisë vihet re se është bërë edhe rivlerësimi i pasurisë në shumën 3.042.882 lekë.

17.4.3 ASHK Drejtoria e Përgjithshme⁷ konfirmon se nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, shtetasit Arta K. Llazari, K. M. Ll. dhe A. K. Ll. rezultojnë

⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶Referohuni formularit nr. *** tek praktika e regjistrimit të dokumenteve të privatizimit të banesave shtetërore Shkodër.

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

aplikues në procesin e legalizimit. Formulari i vetëdeklarimit mban të dhënat me nr. *** prot., datë 19.7.2013.

17.4.4 ALUIZNI Shkodër⁸ konfirmon vetëdeklarimin nr. *** prot., datë 19.,7.2013 në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj, si dhe ka vendosur në dispozicion edhe formularin e vetëdeklarimit, ku përshkrimi i ndërtimit pa leje është “shtesë banese”, me adresë: rruga “***”, pallati ***, kati i ***, Shkodër.

17.5 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë ndërtim/shtesë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 dhe as në deklaratën *Vetting*.

17.6 Komisioni, nisur nga informacioni i administruar për ekzistencën e një ndërtimi informal, shtesë banese, i ka kërkuar⁹ subjektit që të japë shpjegime në lidhje me këtë ndërtim, si dhe të deklarojë shpenzimet dhe burimin e krijimit të këtij investimi. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje ka sqaruar se *ndërtimi konsiston në një shtesë anësore të dhomës së gjumit të banesës, në formën e një ballkoni, i ndërtuar me qëllimin e vetëm për të përmirësuar kushtet e jetesës tek kjo banesë, që relativisht ka sipërfaqe të vogël për të mundësuar sistemimin e mjeteve të ngrohjes, drutë e zjarrit, etj., si dhe si zëvendësues i një këndi për tharjen e rrobave. Ky ballkon është ndërtim që nuk ka themele apo kolona që mbështeten në tokë. Ky ndërtim ka filluar gjatë vitit 2010 dhe ka përfunduar gjatë vitit 2011, me kërkesën dhe investimin fillestar të prindërve të saj. Subjekti ka sqaruar se: “Nga faqja e murit të njëjës dhomë ndërtimi ka gjatësi një metër, ndërsa nga dhoma tjetër dy metra. I gjithë ndërtimi ka një shtrirje rreth 5,5 metra. Ky ndërtim, duke qenë i shtrirë në dy vite dhe punimet janë kryer në disa faza dhe nga disa persona, pagesat janë kryer të ndara, por në total ndërtimi ka pasur vlerën rreth 350.000 lekë. Siç e theksova në fillim, ndërtimi është kryer nga prindërit dhe burimi i krijimit të këtij ndërtimi kanë qenë pensionet e tyre dhe të ardhurat nga puna e babait, natyrisht të kursyera ndër vite”. Lidhur me mosdeklarimin e këtij ndërtimi, subjekti ka sqaruar se ky ndërtim nuk është deklaruar, pasi, në kuptim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 3/pika “g”, “Pronar i ndërtimit pa leje” është personi fizik ose juridik që ka kryer vetë ose ka qenë investitor i ndërtimit pa leje dhe vërteton se e posedon ose e disponon lirisht atë dhe parcelën ndërtimore, pavarësisht nga fakti se pronësia mbi to është e paregjistruar në emër të tij në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Subjekti ka sqaruar se ajo nuk e ka investuar, por ka qenë ndërtim i kërkuar dhe i investuar nga prindërit, që duke mos pasur themele apo kolona që mbështeteshin në tokë nuk është konsideruar “ndërtim”, pasi nuk kishte parcelë ndërtimore. Sipas subjektit, me ligjin nr. 141/2013, që bëri disa ndryshime tek ligji i sipërcituar, u hap një mundësi për legalizimin e këtij lloj ndërtimi, pasi neni 1 i këtij ligji, që ndryshoi nenin 2 të ligjit të vjetër, parashikoi: “Në ndryshim nga kushti i përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, ky ligj mund të zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit, vetëm në rast se për to procedura e legalizimit nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin”. Në këto rrethana, sipas sugjerimit verbal të bërë nga punonjësit e institucionit kompetent, nga të tre bashkëpronarët e banesës ku mbështetej kjo shtesë u plotësua formulari i vetëdeklarimit në korrik të atij viti, 2013. Kjo kërkesë nuk u mor në konsideratë ndonjëherë, duke vijuar e njëjta gjendje, send që juridikisht nuk ekziston. Me ligjin nr. 62/2015 u shfuqizua parashikimi i sapocituar ligjor. Subjekti është shprehur se: “Në këto rrethana nuk e kam vlerësuar se e kam pasur detyrim ligjor deklarimin e këtij ndërtimi dhe dy prindërit e mi nuk kanë qenë persona të detyruar për ta deklaruar një punim të tillë”.*

17.7 Komisioni, për nevoja të mëtejshme të hetimit në lidhje me këtë ndërtim informal, ka kërkuar informacion edhe nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, i cili, në

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 4.9.2017 (aneks nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁹Me pyetësorin nr. 2, datë 31.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

përgjigje¹⁰ ka dërguar pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar për zonën kadastrale nr. ***, konkretisht ortofoto 2001 (data e fotografimit 29.4.2001), ortofoto 2007 (data e fotografimit 24.6.2007) dhe ortofoto 2015 (data e fotografimit 7.6.2015). Nga fotografimi ajror vihet re se shtesa nuk ka ekzistuar në vitin 2007, por është e dukshme vetëm në fotografimin e vitit 2015 dhe, si rrjedhojë e tyre, duket se koha e ndërtimit të kësaj shtese rezulton të jetë pas vitit 2007.

17.8 FSHU-ja¹¹ informon se me gjeneralitetet A. K. LL identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit me nr. ***, në instancën Shkodër, me datë hapjeje 28.10.2003. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar duket se kjo kontratë është e tipit familjar dhe i përket adresës rr. “****”, p. ***, k. ***, Shkodër, e cila përkon me adresën e pasurisë objekt vlerësimi, në të cilën subjekti jeton aktualisht bashkë me prindërit e saj.

17.9 UKT-ja¹² informon se nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime Ujësjiellës - Kanalizime Shkodër, e regjistruar në sistem në emër të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të saj. Komisioni ka pyetur¹³ subjektin për këtë fakt, e cila në përgjigje ka depozituar kopje të librezës, të lëshuar në emrin e nënës A.LL, me nr. klienti ***.

18. Në lidhje me mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie

18.1 Lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, në pjesë takuese ¼ nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është përfitur sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe, për rrjedhojë, nuk ka kryer një analizë financiare, pasi subjekti rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie nga Enti Kombëtar i Banesave, në vlerën 18.860 lekë, nuk ka kontribut financiar, por e ka përfitur për efekt të ligjit ku bashkëpronarë përcaktohen personat madhorë në përbërje të certifikatës familjare të gjendjes datë 1.12.1992.

18.2 Ndërsa, lidhur me blerjen e pjesës takuese të vëllait në vitin 2005, meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 dhe as në atë *Vetting*, Komisioni e ka pyetur¹⁴ atë për burimin e krijimit. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se: *“Çmimi i blerjes së kësaj pjese ideale është siguruar kryesisht nga kursimet e të dy prindërve, që në këtë periudhë kanë qenë pensionistë, si dhe një pjesë prej saj. Dy prindërit e mi kanë pension pleqërie. Babai im që nga koha që ka dalë në pension dhe është lejuar ushtrimi i profesioneve të lira ka ushtruar si profesion dhe atë të doktor-veteriner pranë një farmacie veterinarë apo në familje që mbanin kafshë të nevojshme për kurim, si dhe nëna ime përfiton nga viti 1999, duke qenë invalide e grupit të dytë, një pagesë tjetër si pension invaliditeti. Pjesa e paguar prej meje nuk më kujtohet, pasi ka qenë një veprim mes familjes, por, me sa kujtoj, pjesën më të madhe e kanë paguar prindërit. Burim i të ardhurave të mia ka qenë vetëm paga si gjyqtare”*.

18.3 Komisioni, në rrethana konstatuese të tilla si: (i) subjekti i rivlerësimit rezultoi në të njëjtin trung familjar me prindërit; (ii) pjesa takuese e vëllait (1/4) është blerë nga të tre anëtarët, pra nga subjekti i rivlerësimit, nëna dhe babai; (iii) gjatë hetimit subjekti nuk përcaktoi kontributin e saj në vlerë monetare për këtë pasuri – vlerësoi të kryejë analizën financiare në momentin e investimit, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për të tre anëtarët, si blerës të kësaj pjese takuese.

18.4. Komisioni, pas përlllogaritjeve të kryera lidhur me verifikimin e mundësive financiare për këtë investim, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi

¹⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹Me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2020.

¹³Me pyetësin nr. 2, datë 31.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁴Me pyetësin nr. 2 datë 31.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

financiare të investojnë në blerjen e pjesës takuese të bashkëpronarit B.LL, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

18.5 Komisioni, lidhur me përcaktimin e kohës së këtij ndërtimi, u bazua në deklarinimin e subjektit se ky investim është kryer në vitet 2010 - 2011 në vlerën 350.000 lekë, pasi nga ortofoto dukej se shtesa ishte pas vitit 2007 dhe nuk mund të identifikohet viti i saktë.

18.5.1 Ndërsa, lidhur me përcaktimin e kostos së ndërtimit, edhe pse subjekti nuk depozitoi ndonjë preventiv apo dokumentacion tjetër provues për vlerën e shpenzuar, Komisioni në rastin konkret vlerësoi se nuk mund të bazohet në kostot e ndërtimit nga EKB-ja, pasi ndërtimi në fjalë është shtesë mbi një objekt ekzistues në lartësi, që nuk ka themele (pra njëra faqe e murit është e ndërtuar, është vetëm një shtesë ballkoni) dhe, për këtë arsye, nuk mund të aplikonte çmimet e plota të EKB-së, pasi ato janë çmime referuese për një ndërtim të ri.

18.5.2 Lidhur me përlllogaritjet financiare të kryera për të verifikuar mundësitë e subjektit dhe prindërve për të kryer këtë investim, Komisioni, sa i takon kohës së ndërtimit, u bazua në deklarinimin e subjektit se ky ndërtim ishte kryer në vitet 2010 - 2011, duke e ndarë shpenzimin në mënyrë të barabartë për këto 2 vite.

18.5.3 Nga përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor¹⁵, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për 3 anëtarë (subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e saj), Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi financiare të investojnë në shtesën e banesës (ballkon), si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

18.5.4 Në tërësi për këtë pasuri, Komisioni, pavarësisht konstatimit të provueshmërisë së mundësive financiare për investimet e kryera, referuar nenit 52 të ligjit nr. 842016, i kërkoi subjektit të vijonte të paraqiste argumentet e saj lidhur me: (i) mosdeklarimin e burimit të krijimit të blerjes së pjesës takuese nga vëllai i subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005; si dhe (ii) lidhur me mosdeklarimin e ndërtimit informal/shtesë në deklaratat periodike kur është kryer investimi dhe në deklaratën *Vetting*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.5.5 Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të blerjes së pjesës takuese të vëllait të saj, subjekti ka parashtruar se në asnjë moment nuk ka pasur si qëllim fshehjen e burimit financiar që ka shërbyer për blerjen e 1/3 të 1/4 të apartamentit. Origjina e kësaj banese ishte shtetërore, e cila, në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, u ofrua nga EKB-ja dhe ka qenë gjithë kohën në pronësi të përbashkët të anëtarëve të familjes. Sipas subjektit, kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e vitit 2003 “apartament në bashkëpronësi me ¼ pjesë takuese” dhe në vitin 2005 ka deklaruar blerjen e pjesës së vëllait nga prindërit dhe subjekti. Kjo pasaktësi, ka theksuar subjekti, është e paqëllimshme dhe në dijeninë e saj formulari i deklarimit të pasurive në vitin 2005 nuk e përmbante rubrikën “burimi i krijimit”, rubrikë e cila është shtuar në vitin 2010.

18.5.6 Në lidhje me mosdeklarimin e ndërtimit informal/shtesë në deklaratat periodike kur është kryer investimi dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur të njëjtat shpjegime sikurse përgjatë hetimit administrativ (referuar pikës 17.6 të vendimit). Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se për këtë fakt, sipas procesverbalit të mbajtur në datën 28.6.2021, është pyetur edhe nga inspektori dhe nd/inspektori pranë ILDKPKI-së, ku pas verifikimeve të bëra nuk ka rezultuar ndonjë problematikë në lidhje me deklaratat e saj ndër vite. Po ashtu, subjekti ka referuar si qëndrim të njëjtë vendimin nr. 35, datë 15.12.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe vendimin nr. 262, datë 17.6.2020, të Komisionit, të formës së prerë. Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit, subjekti ka pranuar konstatimin e Komisionit, duke

¹⁵Referuar tabelës nr. 2, në dokumentin “rezultatet e hetimit administrativ të subjektit”, si dhe në analizën financiare në formatin *excel*, administruar në dosjen e subjektit.

shpjeguar se kjo pasaktësi ka ardhur për shkak të konceptimit që burimi i të ardhurave është i qartë dhe i nënkuptuar, për sa kohë të ardhurat kanë qenë nga punësimi dhe jo nga burime të tjera.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

18.6 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

18.6.1 Në lidhje me mosdeklarimin nga subjekti të burimit të blerjes së pjesës takuese të vëllait të saj, trupi gjykues, duke konstatuar se: (i) subjekti në deklaratën periodike të vitit 2003 e ka deklaruar pasurinë “shtëpi banimi, hyrje pallati 2+1, me sip. 72 m²”, nga rrjedh kjo pjesë takuese e krijuar nga privatizimi i banesave shtetërore me kontribut vullnetar të vitit 1992; (ii) subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005¹⁶ ndryshimet e ndodhura në pjesën takuese 1/3 për këtë pasuri dhe specifikisht blerjen e pjesës së njërit prej bashkëpronarëve për vlerën 1.000.000 lekë; (iii) deklaratimet e subjektit përputhen me faktet e dala nga hetimi i Komisionit, ku sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2005, dhe regjistrimit të saj në ZVRPP-në Shkodër në datën 14.10.2005, përshkruhet tjetërsimi i pjesës takuese të njërit prej bashkëpronarëve, konkretisht vëllait të subjektit, me çmim shitjeje të ¼ pjesë reale të pronësisë në kontratë, në vlerën 1.000.000 lekë; (iv) nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe familja e saj kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e saj – i çmon bindëse shpjegimet e subjektit se kjo pasaktësi është e paqëllimshme, duke e vlerësuar pa pasojë në procesin e rivlerësimit të saj, për sa kohë nga kontrolli i kryer mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit të ligjshmërisë së krijimit të këtyre pasurive, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ndodhet në kushtet e parashikuara në ndonjë nga rastet e përcaktuara shprehimisht në nenin 33, pika 5, gerrat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

18.6.2 Në lidhje me mosdeklarimin e ndërtimin informal/shtesë në deklaratat periodike kur është kryer investimi dhe atë *Vetting*, trupi gjykues çmon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte këtë ndërtim, për sa kohë rezultoi si një ndër aplikuesit në procesin e legalizimit dhe, për rrjedhojë, përfituese e të drejtave reale të saj dhe për këtë shkak konstaton se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për këtë pasuri. Trupi gjykues, referuar jurisprudencës së Kolegjtit¹⁷, çmon se kjo pasaktësi në deklarim, e pashoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e këtij investimi, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, nuk përbën shkak për aplikimin e nenit 61, pika 3 e këtij ligji, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

19. Pasuria tokë arë me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në fshatin P, Shkodër, blerë me kontratën e shitblerjes sipas kontratës nr. ***, datë 11.1.2005, nga blerësit B.LL, B.B, A.B dhe Arta Llazari, pasuri e shitur nga shtetasi I.D. Sipas kontratës së shitblerjes kjo pasuri është blerë në total në vlerën 2.000.000 lekë, në bashkëpronësi në tërësi nga ¼ secili. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁸.

¹⁶Sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës.

¹⁷Vendimi nr. ***, datë 12.10.2021.

¹⁸Informacion mbi pasurinë lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër me nr. *** prot., datë 26.10.2016, e cila informon se në emër të shtetasve B.LL, Arta Llazari, B.B dhe A.B është e regjistruar pasuria arë me sip. 1000 m², me nr. pasurie ***, certifikatë për vërtetim pronësie datë 26.1.2005, për pasurinë e llojit “arë” me sip. 1000 m², me nr. pasurie ***, e regjistruar në emër të shtetasve B.LL, Arta Llazari, B.B dhe A.B; hartë treguese e regjistrimit; kërkesë për regjistrim dhe lëshim certifikate, datë 26.1.2005; akt shitblerjeje nr. ***, datë 11.1.2005, për pasurinë e llojit “arë”, me sip. 1000m², me nr. pasurie ***, blerës B.LL, Arta Llazari, B.B dhe A.B, shitës I.D. Çmimi 2.000.000 lekë i likuiduar; akt shitblerjeje nr. ***, datë 17.12.2004, për pasurinë e llojit “arë” me sip. 1000 m², me nr. pasurie ***, blerës I.D, shitës RR.P. Çmimi 1.000.000 lekë i likuiduar (aneks nr. 4/1).

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të pjesës takuese $\frac{1}{4}$ për pasurinë tokë arë me sip. 1000 m², në P, Shkodër, blerë në vitin 2005, në shumën 2.000.000 lekë.

Hetimi i Komisionit

19.2 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit këtë pasuri e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2005, me përshkrimin “Tokë arë në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 1000 m²”. Vlera: 2.000.000 lekë. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit burimi i krijimit për këtë pasuri, për $\frac{1}{4}$ pjesë takuese.

19.3 Nga hetimi rezultoi se ASHK Drejtoria Vendore Shkodër, me shkresën¹⁹ informon se figuron e regjistruar në regjistrat publikë pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “arë”, me sip. 1000 m², në bashkëpronësi të shtetasës Arta Llazari. Kjo drejtori bashkëlidhur ka përcjellë edhe dokumentacionin përkatës. Nga dokumentacioni i administruar konfirmohet se kjo pasuri është blerë nëpërmjet aktit të shitblerjes së pronës nr. ***, datë 11.1.2005, me palë shitëse shtetasi I.D dhe palë blerëse shtetasit B.LL, Arta Llazari, B.B dhe A.B, për pasurinë e paluajtshme të llojit “arë”, me sip. 1000 m², në vlerën 2.000.000 lekë.

19.3.1 Në kartelën e pasurisë së paluajtshme për këtë pasuri, në seksionin D të saj gjendet përshkrimi “në këtë pasuri bie ndërtesa e legalizuar me nr. ***, vol. ***, f. ****”, data e regjistrimit 3.12.2011.

19.4 Nisur nga kjo e dhënë, Komisioni iu drejtua ASHK-së Drejtoria Vendore Shkodër për sqarime të mëtejshme, e cila, në përgjigjen e saj²⁰, ka informuar se ndërtesa me nr. pasurie ***, me sip. 5.3 m², e fituar me leje legalizimi nr. ***, datë 5.8.2021, në bashkëpronësi të shtetasve K.S dhe N.S, pozicionohet mbi pasuritë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë”, me sip. 250 m², në pronësi të shtetasit K.S dhe nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë”, me sip. 1000 m², në bashkëpronësi të shtetasës Arta Llazarit, në $\frac{1}{4}$ pjesë, sipas shënimit në kartelë në seksionin D të saj. Gjithashtu, referuar fragmentit të hartës kadastrale dhe në tërësi gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të praktikës së regjistruar, duket se ndodhemi përballë faktit ku pas legalizimit të ndërtimit informal me nr. pasurie ***, ndërtesë (objekt ndihmës i pasurisë me nr. ***), sipas përshkrimit në lejen e legalizimit, rezultoi se kjo ndërtesë bie pjesërisht si ndërtim në pasurinë nr. ***, duke qenë se këto janë pasuri kufitare dhe ky ndërtim duket se është bërë në kufi të tyre.

19.5 Lidhur me këtë ndërtesë mbi tokën arë, Komisioni pyeti²¹ edhe subjektin, e cila në përgjigje ka sqaruar se: “...me aq sa jemi në dijeni, unë dhe bashkëpronarët e tjerë të pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, ndodhur në fshatin P, Shkodër, kjo pasuri nuk është zhvilluar dhe nuk është kryer ndonjë veprim juridik apo faktik mbi të. Vetëm pas sinjalizimit nga ana juaj u bë e mundur të njohim dhe të vihemi në dijeni se çfarë veprimesh kanë kryer kufitarët dhe ASHK Shkodër mbi këtë pasuri. Me personat që kanë kryer ndërtimin nuk kam njohje dhe as ndonjë lidhje të çfarëdolloji qoftë ajo. Për çfarë pohova më sipër, më është konfirmuar edhe nga dy bashkëpronarët e kësaj pasurie, të cilët për shkak të funksionit të tyre dhe të qenurit person i lidhur, konkretisht gjyqtare A.B dhe shtetasi B.B, bashkëshorti i gjyqtare V.V, kjo pasuri ka rezultuar e pazhvilluar”.

Në mbështetje të deklaramit subjekti ka depozituar pothuajse të njëjtat dokumente që Komisioni ka administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Shkodër.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 24.11.2022.

²⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

²¹Me pyetësorin nr. 4, datë 22.12.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

19.6 Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni, referuar përgjigjes së ASHK-së Shkodër dhe shpjegimeve të subjektit, vëren se duket se ndodhemi përballë faktit ku nuk evidentohet ndonjë ndërtim/investim apo zhvillim i pronës në pasurinë nr. ***.

19.7 Komisioni, gjithashtu, për këtë pasuri hetoi edhe lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi mes shitësit të saj dhe subjektit të rivlerësimit, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër²² nuk konfirmoi që subjekti të ketë kryer ndonjë proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse shtetasin I.D.

19.8 Në lidhje me deklaratimet dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie

19.8.1 Lidhur me deklaratimet e burimit të krijimit për këtë pasuri, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 dhe as në atë *Vetting*. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie për pjesën e saj takuese, në pyetësonin nr. 2 deklaroi se burimi i vetëm janë të ardhurat personale dhe kursimet e saj ndër vite si gjyqtare.

19.8.2 Ndërsa, lidhur me verifikimin e mundësive financiare për këtë investim, Komisioni ka konstatuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar kursime *cash*. Për këtë arsye, Komisioni kreu analizën financiare²³ për investimin e kryer, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar vetëm për subjektin e rivlerësimit nga data 1.1.2005 deri më 11.1.2005.

19.8.3 Komisioni, pas përlogaritjeve të kryera, konstatoi se: (i) dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 434.750 lekë të investojë në blerjen e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera; (ii) dukej se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 dhe as në atë *Vetting*, duke i kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegimet e saj, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

19.9 Në funksion të rezultateve të hetimit për këtë pasuri, subjekti ka parashtruar se pasuria e llojit “tokë arë” me sip. 1000 m², referuar kontratës së shitblerjes datë 11.1.2005, është blerë nga 4 blerës dhe se pagesa që ka bërë secili nga blerësit kundrejt shitësit është bërë jashtë zyrës noteriale, si dhe më përpara në kohë sesa nënshkrimi i kontratës së shitblerjes në datën 11.1.2005 dhe në momente të ndryshme sipas mundësive të gjithsecilit, pasi disa prej tyre nuk jetonin në Shkodër apo kishin lëvizur për festat e fundvit. Subjekti ka shpjeguar se pjesën e saj të çmimit të shitjes ia ka likuiduar blerësit ditët e fundit të dhjetorit 2004, para Vitit të Ri, por vetëm në datën 11.1.2005 është bërë e mundur të mblidheshin të gjithë palët kontraktore së bashku për të formalizuar veprimin juridik.

19.9.1 Sipas shpjegimit të saj, subjekti ka pretenduar se nëse Komisioni do të rikonsiderojë të ardhurat e familjes së saj në bazë të dokumentacionit provues, të depozituara nga ana e saj, e njëkohësisht të pranonte faktin që në fund të viti 2004 subjekti ka pasur një tepricë kreditore, analiza financiare ka rezultat pozitiv. Sipas subjektit të ardhurat e saj në funksionin e gjyqtarës që nga shtatori i vitit 2000 përmbushin standardin e nenit D të Kushtetutës dhe, si të tilla, nëse zbriten shpenzimet e jetesës, këto të ardhura janë të mjaftueshme për të përballuar blerjen e pasurisë tokë arë në janar të vitit 2005.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

19.10 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara,

²²Me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²³Referohuni tabelës nr. 3 në dokumentin e rezultateve të hetimit administrativ për subjektin.

çmon të papranueshëm pretendimin e subjektit se kjo pasuri është likuiduar në dhjetor të vitit 2004, pra përpara hartimit të kontratës noteriale, pasi nga njëra anë rezulton se analiza financiare për vitin 2004 është negative dhe nga ana tjetër konstatohet se subjekti nuk e ka deklaruar këtë veprim/pagesë në deklaratën e vitit 2004, sipas shpjegimit të saj.

19.10.1 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 434.750 lekë për blerjen e pjesës takuese ¼, në pasurinë tokë arë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatim i cili është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

20. Llogari rrjedhëse në “Tirana Bank”, dega Shkodër, me nr. ***, ku janë kaluar pagat si gjuqtare dhe këshilltare, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Vlera: 1.475.235 lekë. Pjesa takuese: 100%.

20.1 Komisioni ka konstatuar se “Tirana Bank”²⁴ konfirmon të njëjtat deklarime sikurse subjekti i rivlerësimit, se ajo ka pasur gjendje në llogarinë e pagës në datën 24.1.2017 vlerën 1.475.235,4 lekë, duke mos evidentuar kështu ndonjë problematikë.

21. Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”, dega Shkodër, me nr. llogarie ***, ku ka kaluar kursimet e saj personale nga rroga dhe shpërblimet e marra gjatë viteve, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Vlera: 2.714.750,69 lekë. Pjesa takuese: 100%.

21.1 Nga hetimi për këtë depozitë rezultoi se “Raiffeisen Bank”²⁵ konfirmon llogari rrjedhëse në emër të subjektit Arta Llazari, me gjendje në datën 24.1.2017, me vlerë 2.714.058,84 lekë. Nga analizimi i të dhënave bankare, Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit nuk përputhej me gjendjen e datës 24.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, por korrespondon me gjendjen e datës 1.10.2016. Po ashtu rezultoi se subjekti nuk ka përfshirë në deklarinimin e saj komisionet bankare. Ky konstatim i Komisionit vlerësohet se nuk passjell ndonjë problematikë në procesin e rivlerësimit për subjektin.

Konstatime të tjera

22. Nga hetimi administrativ, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 depozitë me afat në vitit 2003 në emër të saj, për të cilën nga hetimi i kryer rezultoi:

22.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti ka deklaruar “Depozitë me afat maturimi 6-mujor”. Vlera 1.300.000 lekë, me burim krijimi kursime dhe dhurime nga prindërit.

22.2 Komisioni i ka kërkuar²⁶ subjektit të depozitëj dokumentacion justifikues nga ish-Banka e Kursimeve për të provuar ekzistencën e kësaj depozite, datën e çeljes, historikun e ndryshimeve të saj, si dhe të deklaronte vlerën e dhuruar prej prindërve.

22.3 Subjekti, në përgjigjen e saj, ka sqaruar se: “*Nga verifikimet e kryera nga ‘Raiffeisen Bank’, dega Shkodër, bankë e cila ka trashëguar dokumentacionin e ish-Bankës së Kursimeve, më është konfirmuar se nuk gjejnë ndonjë dokument të vlefshëm që lidhet me këtë depozitë bankare, por mbeten në pritje të një përgjigjeje nga qendra e tyre në Tiranë. Nuk e kujtoj se sa ka qenë pjesa e dhuruar nga prindërit e mi. Deklaroj vetëm se të dy prindërit e mi kanë pasur burim të ardhurash vetëm nga puna e tyre, babai nga pensioni si doktor veteriner dhe si farmacist veteriner i punësuar që nga vitit 1994 deri në pranverën e vitit 2010, si dhe mamaja ime si nëpunëse arkëtare pranë ish-Ndërmarrja Komonale Elektrike, e riorganizuar në fund të*

²⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁶Me pyetësorin nr. 3, datë 23.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

saj si 'S.E' Shkodër, derisa doli në pension në datën 31.12.1999 dhe njëkohësisht ka përfitur pension invaliditeti që nga muaji shkurt i vitit 1999”.

22.4 Nga korrespondenca e Komisionit me “Raiffeisen Bank”²⁷ rezultoi se subjekti ka pasur një depozitë, e cila, në datën 1.10.2004, kur është kryer kalimi/transferimi nga ish-Banka e Kursimeve në “Raiffeisen Bank”, ka pasur vlerën 1.691.350 lekë. “Raiffeisen Bank”, në rrugë elektronike²⁸ gjithashtu ka informuar se kjo depozitë është çelur në datën 21.5.1999, me afat 6-mujor, në vlerë fillestare 150.000 lekë. Nga informacioni i administruar rezultoi se kjo depozitë ka pësuar ndryshime, pra shtesa dhe tërheqje në vite, por nuk identifikohet saktësisht shuma e përfitur nga interesat. Komisioni përlllogarit interesat e mundshme të përfituara nga kjo depozitë, aty ku mund të identifikonte shumën e përfitur si diferencë mes vlerës së datës pasardhëse me atë paraardhëse. Në vlerat që Komisioni ka konstatuar shtesa apo tërheqje nuk i ka përlllogaritur interesat. Nga viti 1999, kur është çelur depozita, deri në datën 30.11.2003 interesat janë përlllogaritur në shumën 417.880 lekë. Në datën 30.11.2003 gjendja e kësaj depozite ka qenë në vlerën 1.349.346 lekë. Analiza financiare për krijimin e kësaj depozite u shtri në kohë për të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe prindërit. Të ardhurat e subjektit u bazuan në vërtetimet²⁹ e lëshuara nga institucionet shtetërore punëdhënëse për periudhën 1998 – 2003, ndërsa për prindërit në shkresën e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Shkodër³⁰, për periudhën 1989 – 2003. Pavarësisht se subjekti ka deklaruar se babai i saj pas daljes në pension ka qenë i punësuar për vitet 1994 – 2010 dhe nëna e punësuar deri në vitin 1999, këto deklarime nuk janë marrë në konsideratë, pasi jo vetëm që subjekti nuk ka deklaruar shumën e përfitur prej tyre, por as e ka provuar me dokumentacion punësimin e prindërve. Për prindërit janë përfshirë në analizë vetëm të ardhurat e përfituara nga pensioni.

22.5 Komisioni në vijim, sipas vlerësimeve të cituara në pikën 22.4, verifikoi mundësitë financiare për krijimin e kësaj depozite, ku pas përlllogaritjeve³¹ të kryera konstatoi se subjekti ka pasur mundësi të investojë në këtë depozitë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, duke mos konstatuar kështu ndonjë problematikë lidhur me këtë pasuri.

23. Komisioni përgjatë hetimit ka konstatuar se në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se: *“Për pak muaj kam përdorur e më pas e kam blerë e sërish rishitur autoveturën tip ‘Skoda-Fabia’ me targa ***, sipas kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 11.3.2009. Ky mjet rezultoi me probleme teknike dhe i është rikthyer sërish shitësit të parë ‘Porsche Albania’ Tiranë”.*

23.1 Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, nga subjekti u vërejt se kontrata e shitblerjes së cituar nr. ***, mban datën 11.2.2009 dhe jo datën 11.3.2009, si dhe nuk korrespondonte me targën ***. Kjo kontratë nr. ***, datë 11.2.2009, i përkiste shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 250.000 lekë. Ky mjet ishte blerë më parë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën³² nr. ***, datë 16.11.2007, për të cilin Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika.

23.2 Ndërsa lidhur me mjetin me targa ***, subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 11.2.2009, me palë shitëse B.LL dhe E.N dhe palë blerëse Arta Llazari. Çmimi i shitjes së këtij mjeti është në vlerën 600.000 lekë.

23.3 Nga hetimi për këtë pasuri rezultoi se blerjen e këtij automjeti subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009. Nisur nga ky fakt, Komisioni e ka pyetur³³

²⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁸Email datë 12.1.2023.

²⁹Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016.

³¹Referohuni në tabelën nr. 5 në dokumentin e rezultateve të hetimit administrativ të subjektit.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, e DPSHTRR-së, administruar në dosjen e Komisionit.

³³Me pyetësorin nr. 2, datë 31.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

subjektin për burimin e krijimit që ka shërbyer për blerjen e tij, si dhe arsyen e mosdeklarimit. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar: “Ky automjet (me targa ***) u ble pasi ishte shitur në datën 11.2.2009 automjeti i markës ‘Mercedes-Benz’, tipi ***, ngjyrë blu, naftë, me targa ***, sipas kontratës noteriale nr. ***, ku shitëse ka qenë Arta Llazari dhe blerës shtetasi G. S. M. Çmimi i shitjes ka qenë 250.000 lekë. Pjesa tjetër e çmimit të blerjes së mjetit të markës ‘Skoda’, me targa *** E ka pasur si burim vetëm të ardhurat e mia të siguruara nga paga si gjyqtare. Lidhur me pyetjen tuaj se pse nuk është deklaruar kjo blerje tek deklarata periodike vjetore e vitit 2009, duke e marrë të mirëqenë konstatimin tuaj, pasi aktualisht nuk i disponoj këto deklarata, mund të them me bindje se ky mosdeklarim mund të ketë pasur si shkak faktin se, me sa unë e kujtoj, këtë mjet nuk arrita ta përdorja siç duhet dhe sa duhej, pasi shfaqti një defekt të rëndë të pariparueshëm dhe po me aq sa unë e kujtoj, shumica e dhënës më është kthyer brenda pak kohëve dhe ky mjet, në dijeninë time, është rishitur nga një subjekt tjetër tregtar. Duke mos e konsideruar si shpenzim të kryer nga ana ime, pasi në mbyllje të vitit kalendarik nuk kam pakësuar mjetet monetare për këtë shpenzim, si dhe nuk kam pasur në pronësi mjetin, brenda të njëjtës periudhë deklarimi, vitit 2009, nuk e kam vlerësuar të arsyeshme që ta deklaroj blerjen e këtij mjeti motorik. Kjo blerje ka qenë e fundit, pasi në pronësinë time nuk kam mjete motorike”.

23.4 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në³⁴ për mjetin me targa *** u vërejt se nuk rezultonte kontrata e blerjes së këtij mjeti nga subjekti i rivlerësimit dhe as rishitja e tij. Për këtë arsye, Komisioni, deri në fazën e mbylljes së hetimit administrativ, në analizën financiare për vitin 2009 përfshiu vetëm shpenzimin për blerjen e këtij mjeti, i cili provohet me kontratën e shitblerjes, depozituar nga subjekti i rivlerësimit. Ndërsa pretendimi i subjektit se ky mjet është rishitur dhe ajo e ka marrë përsëri shumën e shpenzuar, nuk u mor në konsideratë, pasi ky veprim nuk u provua me dokumentacion justifikues.

23.5 Për sa parashtruar/vlerësuar më sipër, Komisioni kreu analizën financiare³⁵ në datën e investimit, duke përfshirë vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara të subjektit të rivlerësimit.

23.6 Komisioni, pas përllogaritjeve të kryera, si dhe në tërësi për këtë pasuri, i kaloi barrën e provës subjektit, pasi konstatoi se: (i) dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi në shumën 309.547 lekë të investojë në blerjen e këtij mjeti, si dhe të mbulojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) dukej se subjekti ka kryer pasaktësi në deklarim, pasi nuk ka deklaruar blerjen e këtij mjeti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009; si dhe (iii) nuk provohej me dokumentacion shitja e këtij mjeti brenda vitit 2009.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

23.7 Në lidhje me konstatimet e Komisionit për këtë pasuri, subjekti ka parashtruar se ajo ka provuar me dokumentacion të plotë se mjeti tip “Skoda” i është shitur subjektit privat “Porsche Albania” sh.p.k. në datën 22.4.2009, me kontratën e shitjes nr. ***, me çmim 5.500 euro dhe pagesa e këtij çmimi është bërë në bankë në datën 22.4.2009, me transfertë bankare nga llogaria e subjektit tregtar tek llogaria e shtetasit B.LL. Nga ana e saj nuk është vlerësuar i arsyeshëm deklarimi i blerjes së këtij mjeti motorik, pasi nuk e ka konsideruar si shpenzim të kryer prej saj sepse në mbyllje të vitit kalendarik nuk ka pakësuar mjetet monetare për këtë shpenzim, si dhe nuk e ka pasur në pronësi mjetin brenda të njëjtës periudhë deklarimi, vitit 2009.

23.7.1 Subjekti i ka kërkuar Komisionit të korrigjojë analizën financiare për vitin 2009, në rubrikën “blerje mjeti ‘Skoda’, targë ***, datë 11.2.2009”, ku është përfshirë vetëm shpenzimi për blerjen e këtij mjeti, i cili provohet me kontratën e shitblerjes të depozituar nga subjekti. Subjekti ka shpjeguar se edhe nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, për mjetin

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁵Referohuni në tabelën nr. 12 në dokumentin e rezultateve të hetimit.

me targa ***, provohet fakti se nuk rezultoi të jetë regjistruar kontrata e blerjes së këtij mjeti nga subjekti dhe as rishitja e tij, duke pretenduar korrigjimin e analizës financiare, duke hequr nga kjo analizë pasurinë automjet tip “Skoda Fabia” në vlerën 600.000 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

23.8 Trupi gjykues, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara në raport me shpjegimet e subjektit se shuma i është kthyer dhe se ka provuar me dokumentacion shitjen e këtij mjeti nga vëllai i saj te “Porsche Albania”, çmon se marrja ose jo në konsideratë e kësaj shume nuk passjell efekt në analizën financiare vjetore, pasi për vitin 2005 analiza financiare ka rezultuar pozitive. Trupi gjykues, në këtë çështje objekt vlerësimi, rikonstaton se subjekti rezulton me një pamundësi financiare në momentin e investimit, pikërisht në datën 11.2.2009 dhe, për pasojë, vlerësoi se nga ana e saj nuk janë dhënë shpjegime bindëse për këtë rrethanë.

23.9 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të investojë në shumën 309.547 lekë për blerjen e këtij mjeti, si dhe të mbulojë shpenzimet e tjera familjare, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

24. Në vijim të çështjes së konstatimeve të tjera, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka përdorur³⁶ për të dalë jashtë vendit disa automjete, të cilat nuk janë në pronësinë e saj.

24.1 Komisioni e ka pyetur³⁷ subjektin lidhur me këtë fakt, e cila në përgjigje të saj ka qartësuar marrëdhënien me pronarët/përdoruesit e automjeteve, si dhe ka deklaruar në lidhje me situatën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit. Më konkretisht, në vijim, paraqiten rastet objekt hetimi lidhur me udhëtimet e subjektit.

24.1.1 Lidhur me udhëtimet e kryera me mjetet me targa ***, ***, ***, ***, dhe ***, subjekti ka sqaruar se ato kanë qenë në pronësi të vëllait të saj B.LL. Ndërsa, për mjetin me targa ***, subjekti qartësoi se ishte mjeti i vëllait të saj i markës “Skoda”, që në fakt ka targën *** dhe që gabimisht është shkruar në disa dokumente me targa ***.

24.1.2 Komisioni iu drejtua DPSHTRR-së, e cila në përgjigje³⁸ ka konfirmuar se mjetet me targa ***, ***, ***, ***, dhe *** kanë qenë në pronësi të shtetasit B.LL, vëllai i subjektit.

24.1.3 Ndërsa, për targën ***, nga analizimi i hyrje - daljeve në sistemin TIMS rezultoi se dalja nga Republika e Shqipërisë është regjistruar me mjetin me targa *** dhe hyrja me mjetin me targa ***.

24.1.4 Në përfundim, Komisionit, nga analizimi i të dhënave të dala, i rezultoi se kemi të bëjmë me një lapsus në regjistrim, pasi ky gabim identifikohet vetëm në një udhëtim dhe, për rrjedhojë, nuk konstatoi ndonjë problematikë.

24.2 Po ashtu, nga hetimi rezultoi se subjekti kishte udhëtuar me mjetin me targa *** tip “Daimler Chrysler”, për të cilin ka deklaruar se i përket shtetasit S. (C) H., që është bashkëshorti i bashkëmoshatares së saj dhe njëkohësisht kolege e quajtur S.M, me të cilën ka kryer arsimin e lartë juridik dhe me të ka bërë udhëtime turistike shoqërore apo familjare. Lidhur më këtë konstatim, subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigjeje³⁹ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila nuk konfirmon procese gjyqësore të zhvilluara me këtë shtetas, si dhe ka vendosur në dispozicion një vendim gjyqësor⁴⁰ për të provuar se ka zhvilluar një

³⁶Nga korrespondenca e Komisionit me Policinë e Shtetit³⁶ për hyrje - daljet jashtë territorit të vendit.

³⁷Pyetësor nr. 2, datë 31.10.2022 dhe pyetësor nr. 6, datë 9.1.2023.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022.

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2023.

⁴⁰Vendim nr. ***, datë 13.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, administruar në dosjen e Komisionit.

proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse një shtetas me të njëjtin emër e mbiemër, por me tjetër atësi.

24.2.1 Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatoi se nuk evidentohet ndonjë problematikë në adresë të subjektit.

24.3 Nga hetimi rezultoi se subjekti kishte udhëtuar me mjetin me targa *** në dy udhëtime edhe me shtetasin B. B. B., përkatësisht në datat 24.7.2011 dhe 13.4.2015.

24.3.1 Nga aksesi në median *online*⁴¹ duket se shtetasi B ushtron profesionin e avokatit. Nga të dhënat e aksesuara në QKB⁴² rezultoi se shtetasi B është regjistruar si person fizik në ushtrimin e profesionit të avokatit në datën 20.3.2006.

24.3.2 Subjekti, pasi është pyetur në lidhje me marrëdhënien me shtetasin B, ka deklaruar se ai është avokat dhe se ka njohje me të prej kolegut të saj G.M. Në të dyja rastet ka qenë grup shoqëror që kanë lëvizur me këtë mjet, duke sqaruar gjithashtu se në datën 13.4.2015 nuk ka qenë në detyrë si gjyqtare, pasi KLGJ-ja e ka rikthyer në detyrë si gjyqtare nga ndihmëse ligjore e Gjykatës Kushtetuese, në datën 29.4.2015.

24.3.3 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se për shkak të ushtrimit të këtij profesioni beson se shtetasi B ka përfaqësuar në gjykatë procese gjyqësore kryesisht të natyrës penale. Në mbështetje të deklarimit, subjekti ka depozituar të dhënat e vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴³, nga ku rezulton se faktikisht shtetasi B ka ndjekur procese gjyqësore si palë ndërgjyqëse apo me cilësinë e përfaqësuesit ligjor, por me të tjera subjekte rivlerësimi dhe jo me subjektin e rivlerësimit, objekt i këtij hetimi administrativ.

24.3.4 Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në tërësi për këtë rast, konstatoi se nuk evidentohet ndonjë problematikë në adresë të subjektit.

24.4. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte udhëtuar në datën 20.3.2016 me mjetin me targa *** në një udhëtim edhe me shtetasin E. Sh. Al.

24.4.1 Nga aksesi në median *online*⁴⁴ duket se shtetasi A. ushtron profesionin e lirë të avokatit. Nga të dhënat e aksesuara në QKB⁴⁵ konstatohet se shtetasi është regjistruar si person fizik për ushtrimin e aktivitetit të avokatit në datën 23.9.2014.

24.4.2 Komisioni, nga dokumentacioni i administruar⁴⁶, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e saj nr. ***, datë 20.8.2020, për kërkesën penale me objekt “vendosje e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit S.S”, ka vendosur “pranimin e kërkesës sipas objektit të saj” dhe vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg”, po sipas kërimit të organit të akuzës.

24.4.3 Komisioni konstatoi se në këtë proces gjyqësor i dyshuari Stjuart Smakaj përfaqësohej nga av. E.A, me nr. licence *** dhe me NUIS ***.

24.4.4 Lidhur me marrëdhënien me këtë shtetas, subjekti përgjatë hetimit deklaroi⁴⁷: “Në dijeninë time ky avokat nuk ka mjet motorik personal ose së paku nuk e kam parë dhe nuk kam qenë ndonjëherë pasagjere e mjetit të drejtuar prej tij. Nuk e kam parasysh rastin apo rastet kur ju i referoheni sistemit TIMS, në kohë dhe në persona, por me siguri them të njëjtin sqarim që kam dhënë për pyetjen tuaj për av. B.B. Konkretisht kemi pasur shoqëri të përbashkët me shtetasit G.M, gjyqtar, tashmë i verifikuar dhe i konfirmuar me vendim të formës së prerë nga ana e institucionit tuaj, G. S. B, përmbarues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër etj.”.

⁴¹https://www.yellow***

⁴²Shihni ekstraktin e QKB-së, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³Me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁴[Shkodër: Vrau ***](#)

⁴⁵Shihni ekstraktin e QKB-së, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶Pyetësor nr. 7, datë 18.1.2023.

⁴⁷Pyetësor nr. 8, datë 19.1.2023.

24.4.5 Komisioni i kërkoi⁴⁸ Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër informacion lidhur me gjykime të mundshme të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit me këtë shtetas, në cilësinë e palës ndërgjyqëse, apo të përfaqësuesit.

24.4.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴⁹ konfirmon se nga kontrolli në sistemin e menaxhimit të të dhënave gjyqësore nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer procese ku shtetasi A. të ketë qenë palë ndërgjyqëse.

24.4.7 Komisioni, nga të dhënat e dala prej hetimit për këtë rast/udhëtim, nën konstatimet e rezultuara se subjekti kishte udhëtuar me shtetasin A., me profesion avokat, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, i kërkoi subjektit shpjegime, pasi dukej se këto rrethana në perceptimin e publikut mund të cenonin pozitën e saj si subjekt/magjistrat.

24.4.8 Në qëndrimin e saj⁵⁰ subjekti shpjegon se i qëndron të njëjtit shpjegim që ka dhënë gjatë hetimit, duke rikonfirmuar faktin se lëvizja me këtë shtetas ka qenë tërësisht rastësore, një herë e vetme, në përbërje të një grupi shoqëror, në prani të një kolegu tjetër.

24.4.9 Trupi gjykues, në këtë çështje objekt vlerësimi, nisur nga faktet se: (i) në këtë udhëtim subjekti nuk shfaqet në cilësinë e drejtueses së mjetit; (ii) nga verifikimet e kryera nga Komisioni rezultoi një rast/udhëtim i vetëm; (iii) vendimi për masën e sigurimit ndaj shtetasit S.S, i përfaqësuar nga av. E.A, është dhënë pas 4 viteve; (iv) subjekti, me vendimin e saj nr. ***, datë 20.8.2020, për kërkesën penale me objekt “vendosje e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit S.S”, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vendosur masën e sigurimit “arrest me burg” sipas kërimit të organit të akuzës – pavarësisht se subjekti duhet të tregojë kujdesin e shtuar për evidentimin e çdo rrethane që mund të pasjellë perceptime negative lidhur me figurën e saj, në rastin konkret çmon se nuk ka rrethana të tilla faktiko-ligjore, që mund të vlerësohen negativisht për figurën e saj.

Deklarimi i personave të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016

25. Sa i takon kësaj çështjeje, Komisioni konstatoi se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit rezultoi se babai dhe nëna e subjektit janë në të njëjtën përbërje familjare me të dhe, si të tillë, mbajnë statusin e personit të lidhur, duke deklaruar pasuritë veçmas sipas detyrimit ligjor.

Lidhur me deklarimin e babait të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit të lidhur

26. Pasuria apartament me sip. 71 m², e ndodhur në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***, Shkodër, e cila rezultoi e deklaruar nga babai i subjektit: *“Privatizimi i banesës sipas ligjit nr. 7552, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, nga unë K.LL dhe A.LL. Privatizuar me të hollat e siguruar nga puna (paga) dhe pensioni im dhe paga e bashkëshortes sime. Pas rivlerësimit në datën 1.2.2012, ky apartament është vlerësuar në masën 3.042.882 lekë. Në bashkëpronësi në tërësi nga 1/3 secili”.*

26.1 Nga verifikimi i deklaramëve dhe gjendjes së akteve në dosje, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit dhe se është trajtuar/arsyetuar në deklarimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë çmon të mos bjerë në përsëritje.

27. Likuiditete cash jashtë sistemit bankar, në vlerën 1.490.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten

⁴⁸Shkresë nr. ***, datë 18.1.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁴⁹Shkresë nr. ***, prot., datë 19.1.2023.

⁵⁰Në seancë dëgjimore.

27.1 Komisioni, lidhur me këtë likuiditet, duke konstatuar se babai i subjektit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të likuiditeteve *cash*, ka pyetur⁵¹ subjektin për burimin e krijimit të tyre, e cila përgjatë hetimit deklaroi se: “...besoj se me kalimin e viteve dhe rritjen e pagës sime si gjyqtare ata kanë pasur mundësi të kursejnë më shumë, për më tepër që edhe unë, si bashkëjetuese me ta, kam shpenzuar mjaft nga paga ime si gjyqtare për krijimin e një jetese sa më të përshtatshme për ta, duke iu referuar moshës së thyer dhe gjendjes së tyre shëndetësore. Aktualisht babai im është në moshën 88-vjeçare dhe nëna është në moshën 79-vjeçare. Në këto rrethana ata kanë pasur mundësi të kursejnë më shumë, duke shpresuar që të mos i shpenzojnë më pas për mjekimin dhe arsye të tjera më të rënda”.

27.2 Komisioni, lidhur me verifikimin e mundësive financiare të prindërve të subjektit për kursimin e shumës 1.490.000 lekë, në kushtet që ata nuk e kanë pasur detyrimin për deklarim, nuk kreu analizë financiare vjetore, por e ka shtrirë/analizuar atë në periudhën 2009 – 2016 për shkak të konstatimit të disa veprimeve financiare të kryera nga nëna e subjektit në vitin 2008 (trajtuar në vijim në këtë vendimmarrje).

27.3 Komisioni kreu analizën financiare duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve, ku pas përlllogaritjeve⁵² konstatoi se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi të krijojnë gjendjen *cash* të deklaruar, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

Lidhur me deklarimin e nënës së subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit të lidhur

28. Pasuria apartament me sip. 71 m², e ndodhur në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***, Shkodër, e cila rezultoi e deklaruar nga nëna e subjektit me të njëjtat deklarime si bashkëshorti dhe vajza e saj, pasuri kjo e trajtuar/arsyetuar në deklarimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, e vlerësuar në këtë mënyrë nga Komisioni, që sërish të mos bjerë në përsëritje.

29. Likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, në vlerën 1.490.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Këtë likuiditet Komisioni e ka trajtuar/arsyetuar më sipër në deklarimin e babait të subjektit të rivlerësimit.

30. Depozitë e vitit 2004 në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit

30.1 Gjatë hetimit ka rezultuar se nëna e subjektit A.LL ka depozituar në datën 23.1.2004 në BKT⁵³ shumën 1.355.000 lekë. Kjo shumë është investuar në depozitë dhe ka pësuar ndryshime (pakësuar dhe shtuar) në vite.

30.2 Komisioni i ka kërkuar⁵⁴ subjektit të deklarojë burimin e krijimit të kësaj depozite në vitin 2004, si dhe të shtesave të pësuar në vite. Subjekti në përgjigje ka deklaruar: “...nëna ime ka pasur si burim të ardhurash vetëm rrogën e saj dhe pensionin e invaliditetit. Sigurisht, si administruese e ekonomisë familjare ka përdorur edhe burimet financiare të bashkëshortit të saj dhe pjesërisht edhe të dy fëmijëve të saj”.

30.3 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe, për pasojë, Komisioni nuk ka përfshirë në analizë kursime të mundshme të saj të cilat mund të kenë shërbyer si burim krijimi për këtë depozitë. Meqenëse subjekti nuk ka pasur detyrim për deklarimin e personave të lidhur, Komisioni ka vlerësuar që balanca pozitive e rezultuar në fund vitin 2003 në shumën 526.197 lekë të përfshihet në analizë si kursime të prindërve. Si rezultat i marrjes në konsideratë të këtij kursimi rezultoi se prindërit e subjektit kanë pasur në dispozicion vetëm këtë shumë dhe jo shumën 1.355.000 lekë për të çelur depozitën në datën 23.1.2004, pra 526.197 lekë – 1.355.000 = (827.803 lekë).

⁵¹Pyetësor nr. 3, datë 23.11.2022.

⁵²Referohuni në tabelën nr. 4 në dokumentin e rezultateve të hetimit për subjektin, si dhe analizës financiare në formatin *excel*.

⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2020, nga Banka Kombëtare Tregtare.

⁵⁴Pyetësor nr. 3, datë 23.11.2022.

30.4 Komisioni për këtë pasuri/depozitë në emër të nënës i kaloi barrën e provës subjektivit për të provuar të kundërtën e rezultatit, pasi dukej se prindërit e saj nuk kanë pasur mundësi në shumën 827.803 lekë të investojnë në këtë depozitë në janar të vitit 2004.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit

30.5 Në qëndrimin e saj për këtë balancë negative, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar të ardhura më të larta për familjarët e saj, si dhe ka depozituar dokumentacion për t'i provuar ato. Në këtë drejtim, subjekti ka parashtruar se sipas dokumentacionit të paraqitur nëna e saj ka qenë në marrëdhënie pune deri në datën 1.1.1999 dhe totali i të ardhurave të realizuara⁵⁵ rezulton në shumën 449.563 lekë. Sipas subjektivit, Komisioni ka llogaritur gabim të ardhurat nga pensioni për vitin 1998, pasi nëna e saj ka dalë në pension në datën 1.2.1999. Bazuar në këto të dhëna subjekti ka parashtruar se të ardhurat që duhet të shtohen në analizë financiare për nënën e saj janë në shumën 374.191 lekë (449.563 lekë - 75.372 lekë).

30.5.1 Po ashtu, subjekti ka pretenduar se referuar librezës origjinale të punës së nënës së saj rezulton se ajo ka qenë punonjëse për periudhën 1.7.1980 – 31.12.1990 në Ndërmarrjen Elektro-Ujësjellës, në pozicionin llogaritare. Për periudhën 1.1.1991 – 31.12.1996 ka punuar si llogaritare në Ndërmarrjen Komunale. Në pamundësi për të siguruar listëpagesat e viteve 1990 – 1993 në lidhje me pagën i është referuar pagës referuese para viteve 1994, sipas tabelës së pagave të VKM-së Nr. 561 të vitit 2005, për pozicionin specialist i mesëm, me pagë 3.507 lekë/muaj, që në total arrijnë në vlerën 168.336 lekë. Në këto kushte, sipas subjektivit, të ardhurat e nënës së saj për periudhën 1990 – 1998, rezultojnë në vlerën 542.527 lekë më tepër (374.191 lekë + 168.336 lekë).

30.5.2 Në përfundim, lidhur me të ardhurat e nënës, subjekti ka kërkuar korrigjimin e tyre, pasi sipas tabelës së analizës financiare të Komisionit deri në vitin 2003 këto të ardhura janë përlllogaritur në vlerën 966.914 lekë, por në bazë të dokumentacionit të paraqitur prej saj janë në vlerën 1.509.441 lekë.

30.6 Në lidhje me përlllogaritjet e Komisionit për të ardhurat e siguruar nga babai i saj, subjekti ka kërkuar korrigjimin e analizës financiare, pasi Komisioni duhet të marrë në konsideratë faktet që babai i saj ka ushtruar profesionin e mjekut veteriner dhe ka qenë i licencuar në këtë fushë. Për këtë shkak, është shprehur subjekti, babai është punësuar nga personi fizik "I.Z" në aktivitetin "farmaci veterinar", i cili fillimisht u regjistrua në emër të babait të saj për vitet 1994 - 1995 dhe më vonë babai vijoi si i punësuar deri në pranverën e vitit 2010. Subjekti parashtrroi se gjatë kësaj periudhe babai i saj është paguar me pagë reference minimale, provuar me vërtetimin përkatës nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega rajonale Shkodër, si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.2.2023, të subjektivit tregtar "I.Z". Sipas subjektivit, referuar VKM-ve për pagën minimale ndër vite⁵⁶, të ardhurat nga puna e babait të saj për periudhën 1994 – shkurt 2010 rezultojnë në shumën totale 1.699.563 lekë. Pra, sipas subjektivit, të ardhurat e siguruar nga puna e babait të saj deri në fund të vitit 2003 janë në shumën 528.426 lekë, shumë kjo që duhet t'u shtohet të ardhurave të siguruar nga pensioni (796.599 lekë + 528.426 lekë = 1.325.025 lekë).

30.7 Për sa i takon analizës financiare, subjekti ka parashtruar se deri në vitin 2003 nuk janë pasqyruar/llogaritur të ardhurat e siguruar nga punësimi i vëllait të saj. Lidhur me provueshmërinë e tyre, subjekti ka depozituar dokumentin vërtetim datë 23.3.2000, lëshuar nga DPT/Dega e Tatim-Taksave Shkodër, ku citohet: "...vërtetohet se 'A' sh.p.k. me kodin fiskal nr. ***, datë 26.5.1995, NIPT ***, me pronare znj. M. M. P, me objekt veprimtarie 'agjenci shitjesh biletash'. Lëshohet ky vërtetim për efekt se ka hapur filial në Shkodër me objekt

⁵⁵Referuar vërtetimit të depozituar për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* të nënës së saj sipas pagës *neto* për vitet 1994 – 1998.

⁵⁶Referojuni tabelës së paraqitur nga subjekti në dokumentin parashtrime përfundimtare, depozituar në datën 6.2.2023.

veprimtarie shitje biletash. Përfaqësues në Shkodër është z. B.LL, me adresë: lagjja ‘***’, rruga ‘***’ 1990. Marrëdhëniet e detyrimeve i ka me qendrën në Tiranë, përfshirë edhe TVSH-në”. Për periudhën 1995 – 2000, për vëllain e saj, subjekti ka parashtruar se nuk ka arritur të siguronte listëpagesa.

30.7.1 Subjekti deklaron se Bashkia Shkodër⁵⁷ i ka kthyer përgjigje se subjekti B.LL ka qenë regjistruar si biznes ... – pa datë fillimi. Referuar dokumentacionit shkresor, shtetasi B.LL figuron i regjistruar si subjekt tregtar në datën 27.3.2001, me vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Po kështu rezulton se ka paguar tatim qiraje për objektin ku zhvillonte aktivitet, sipas shkresës nr. *** prot., datë 30.3.2001. Të njëjtin qëndrim mban edhe Drejtoria e Arkivit Qendror në kthim përgjigjen e saj nr. *** prot., datë 27.12.2022, drejtuar Komisionit, se nuk mund të konfirmojë periudha të kontributeve apo pagave mbi të cilat është siguruar nga vëllai i subjektit, në qoftë se mungon dokumentacioni lidhur me emërimin në vendin e punës, NIPT-in e subjektit, fotokopje e librezës së punës, etj. Sipas subjektit, në kuadër të parimit të objektivitetit në gjykim, problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore, nuk duhet të rëndojnë mbi të si subjekt rivlerësimi.

30.7.2 Subjekti ka parashtruar se me anë të shkresës së depozituar, datë 2.2.2023, ka kërkuar pranë Drejtorisë së Tatim-Taksave Shkodër informacion për të ardhurat e vëllait të saj si përfaqësues i shoqërisë “A” sh.p.k. dhe në pamundësi të gjetjes së dokumentacionit nga institucioni përgjegjës për menaxhimin e të ardhurave të biznesit ka depozituar dokumentacionin që ka ruajtur i vëllai për biznesin, si: (i) NIPT-in ***, me objekt “shërbime komisionere për shitje biletash”, regjistruar në datën 27.3.2001; (ii) licencën në emër të shtetasit B.LL; (iii) vërtetimin e Degës Rajonale të Tatimeve Shkodër; si dhe (iv) kontratë qiraje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 15.3.2000. Po ashtu, subjekti me qëllim llogaritjen e të ardhurave nga puna si agjent i punësuar shitjesh pranë kompanisë private si më sipër, i është referuar pagës mesatare të periudhës 1995 – 2000 (mesatares së pagës minimale dhe asaj maksimale të VKM-së në fuqi të asaj periudhe), që sipas saj arrin në shumën 765.428 lekë.

30.7.3 Në vijim, për të ardhurat e realizuara nga vëllai i saj, subjekti ka parashtruar se për periudhën 2000 – 2001 ai ka punuar me një projekt të huaj, për të cilin është paguar nëpërmjet Bankës Italo-Shqiptare dhe pasqyrohen me *statement* të llogarisë bankare nr. ***, llogari në euro të “Intesa Sanpaolo Bank”. Sipas kësaj llogarie rezultojnë të ardhura në shumën 13.100 euro, për të cilat subjekti pretendon se duhet të shtohen si të ardhura në përlllogaritjet e gjendjes financiare të vitit 2003.

30.7.4 Sipas subjektit, vëllai i saj është regjistruar si subjekt tregtar me vendimin nr. ***, datë 27.3.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “shitje biletash udhëtimi”. Subjekti, referuar vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, datë 25.1.2023, ku citohet: “Vërtetojmë se B.LL për periudhën prill 2001 – dhjetor 2005 ka realizuar të ardhura mbi të cilën ka derdhur kontribute (3 vërtetime)”, parashtron se ky dokument provon në mënyrë të pakontestueshme që shtetasi B.LL ka ushtruar veprimtari tregtare në formën e personit fizik dhe ka realizuar të ardhura para vitit 2003, të ardhura të cilat duhet të pasqyrohen në analizën financiare.

30.7.5 Po ashtu, subjekti, për të provuar veprimtarinë dhe të ardhurat financiare të vëllait të saj, ka depozituar një çek në formën e urdhërpagesës, i cili i ka dhënë të drejtën të tërheqë nga banka italiane një shumë prej 10.800.000 liretash, në janar të vitit 2001, që referuar kursit të këmbimit valutor sipas Bankës së Shqipërisë për periudhën janar 2001, kjo e ardhur konvertohet në vlerën 737.856 lekë.

⁵⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

30.7.6 Subjekti, për sa ka parashtruar më sipër, ka kërkuar korrigjimin e analizës financiare, duke pretenduar se totali i të ardhurave për familjen Llazari (4 anëtarët e saj) rezulton i bazuar me dokumente justifikuese në vlerën 8.220.176 lekë deri në vitin 2003.

30.7.7 Në vijim, subjekti, duke iu referuar dokumenteve që ndodhen në dosjen e saj për vëllain B.LL si person fizik, me licencë NIPT ***, me objekt “shërbime komisionere për shitje biletash”, regjistruar në datën 27.3.2001, ka parashtruar në formë tabelare të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2001 – 2008 nga aktiviteti i tij, ku fitimi *neto* arrin në shumën 15.076.210 lekë.

30.7.8 Në qëndrimin e saj, subjekti ka pretenduar rishikimin e analizës financiare, pasi vëllai i saj ka blerë një apartament banimi në vitin 2005 dhe po kështu ka paguar edhe këstet për këtë pasuri të paluajtshme nëpërmjet bankës, por Komisioni në analizën financiare të kryer nuk ka llogaritur të ardhurat e vëllait në vlerën 1.000.000 lekë, të realizuara nga shitblerja e pjesës takuese të apartamentit të përfituar me privatizimi nga 4 anëtarët e familjes Llazari.

30.8 Në seancën dëgjimore subjekti ka pretenduar gjithashtu edhe përlllogaritjen e të ardhurave të përfituara për vitet që ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

30.9 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave të dokumentuara nga ana e saj, në raport me faktet e konstatuara, ka marrë në shqyrtim nivelin e provueshmërinë së tyre, duke çmuar kështu efektet e rivlerësimit për sa arsyetohet si vijon:

30.10 Lidhur me pretendimin për përfshirjen e të ardhurave të përfituara nga punësimi i nënës së subjektit

30.10.i Për vitet 1994 – 1998, subjekti ka depozituar dokumentin “vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare me punëdhënësin ‘S. E. Shkodër’”, nga ku rezulton se nëna e subjektit ka përfituar në total shumën 453.063 lekë. Trupi gjykues çmon se këto të ardhura provohen sipas kërkesave të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, duhet të merren në konsideratë.

30.10.ii Për periudhën 1.1.1991 – 31.12.1996, subjekti ka depozituar librezën e punës së nënës së saj, ku identifikohet punësimi në pozicionin “****” pranë N. K. E. Shkodër. Trupi gjykues, nisur nga fakti se këto të ardhura i referohen një periudhe të largët kohore, e gjen të pranueshëm dhe bindës pretendimin e subjektit për t’i konsideruar të ardhurat sipas pagës referuese para viteve 1994, pasqyruar në tabelën e pagave të VKM-së Nr. 561, datë 12.8.2005.

30.10.iii Në këtë drejtim, trupi gjykues konstaton se, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 12.8.2005, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, paga referuese për pozicionin specialist i mesëm (ku përfshihet edhe pozicioni llogaritë) është në masën 3.507 lekë/muaj. Sipas kësaj page rezulton se për vitet 1990 – 1993, të ardhurat e përfituara janë në masën 168.336 lekë (48 muaj x 3.507 lekë).

30.10.iv Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon t’i marrë në konsideratë të ardhurat nga punësimi për nënën e subjektit për vitet 1991 – 1998, ku në total janë në shumën 621.399 lekë, duke i përlllogaritur në analizën financiare.

30.11 Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të të ardhurave të siguruara nga babai i saj, pasi ai ka qenë i punësuar nga personi fizik “I.Z” në aktivitetin “farmaci veterinare”, i cili fillimisht është regjistruar në emrin e babait të saj për vitet 1994 - 1995 e më vonë si i punësuar deri në pranverën e vitit 2010, trupi gjykues, pasi analizoi provat e depozituara, konstatoi se:

30.11.i Në vërtetimin nr. *** prot., datë 5.12.2022, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Shkodër, rezulton se shtetasi K.M.LL është i siguruar si i vetëpunësuar fizik nr. ***, Shkodër, për periudhën 1.5.1994 – 31.12.1995, ndërsa për periudhën 1.1.1995 – 28.2.2010, të deklaruar tek personi fizik “I.Z”, ai nuk figuron i siguruar.

30.11.ii Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.2.2023, të shtetasit I.Z, ky i fundit ka deklaruar se aktivitetin e tij privat “farmaci veterinarë” nga viti 1994 - 1995 e ka regjistruar në emrin e shtetasit K.LL, i cili ka qenë i pajisur me licencë si ***. Ai, në vijim, ka deklaruar se shtetasi K.LL ka punuar pranë farmacisë së tij “I.Z” për periudhën 1.1.1996 – 28.2.2010, si ***, por meqenëse ai ishte në pension nuk e ka deklaruar për efekt të sigurimeve shoqërore.

30.12 Trupi gjykues, bazuar në dokumentacionin e administruar, vlerësoi të mos e marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për përfshirjen e të ardhurave të pretenduara për periudhën 1995 – 2010, pasi babai i subjektit në këto vite ka qenë në pension dhe nuk figuron i siguruar pranë ndonjë aktiviteti tregtar, ndërsa për periudhën maj 1994 - dhjetor 1995, trupi gjykues vlerësoi të marrë në konsideratë pretendimin e subjektit, pasi babai i saj rezulton si i vetëpunësuar dhe përlllogaritjet për këtë periudhë janë kryer për pagë minimale dhe, specifikisht, për vitin 1994 sipas VKM-së Nr. 610, datë 31.12.1993, paga minimale ka qenë në vlerën 2.560 lekë, për vitin 1995, sipas VKM-së Nr. 42, datë 23.1.1995, paga minimale ka qenë në vlerën 3.180 lekë. Në total, të ardhurat e përfituara për periudhën maj 1994 - dhjetor 1995 janë në vlerën 58.640 lekë⁵⁸.

30.13 Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit të përfituara për periudhën 1998 – 2000 gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës, trupi gjykues ka vlerësuar t’i përfshijë ato, pasi është një pagesë, e cila realisht është përfituar nga subjekti, ashtu sikurse të gjithë studentët e Shkollës së Magjistraturës. Trupi gjykues për të përcaktuar shumën e përfituar për këtë periudhë u bazua në vlerën e përfituar nga subjekte të tjera rivlerësimi, të cilat kanë kryer Shkollën e Magjistraturës në të njëjtën periudhë⁵⁹ më subjektin e rivlerësimit. Të ardhurat e përfituara nga bursa në Shkollën e Magjistraturës rezultojnë në vlerën 441.810 lekë.

30.14 Në përfundim, si rezultat i marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizë të ardhurat e përfituara nga prindërit, nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga interesat bankare nga depozita e çelur që prej vitit 1999, të arsyetuara më sipër në këtë vendimmarrje, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu ripërlllogaritjet që janë pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Vitet 1989 – 2003
1	TË ARDHURA	5,162,359
	Të ardhura nga paga subjekti	2,300,927
	Të ardhura nga pensioni dhe paga babai	855,239
	Të ardhura nga pensioni + përfitimi nga invaliditeti (nëna)	1,588,313
	Të ardhura nga interesat bankare	417,880
2	SHPENZIME	2,351,204
	Shpenzime jetese (vitet 1989 - 1999), 66% e të ardhurave	1,174,836
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së (vitet 2000 – 2003)	1,126,368
	Shpenzime qiraje (5.000 lekë/muaj)	50,000
3	PASURI	1,368,206
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Shtëpi banimi, hyrje pallati 2+1, sip. 72 m ² (paguar më 10.6.1993)	18,860
	Banka	1,349,346
	DIFERENCA (1-2-3)	1,442,949

⁵⁸Për vitin 1994, 8 muaj x 2.560 lekë/muaj = 20.480 lekë dhe për vitin 1995, 12 muaj x 3.180 lekë/muaj = 38.160 lekë.

⁵⁹https://www.*** magjistratë të diplomuar në vitin 2001, në të njëjtin vit me subjektin e rivlerësimit. Referuar vendimeve nr. ***, datë 21.6.2019 dhe nr. ***, datë 27.7.2020, të Komisionit.

30.15 Nga analiza financiare rezultoi se në fund të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi të kursejnë shumën 1.442.949 lekë. Trupi gjykues ka vlerësuar që kjo balancë pozitive të përfshihet në analizë e gjitha si kursim i prindërve. Si rezultat i marrjes në konsideratë të këtij kursimi prej 1.442.949 lekësh rezulton se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi për të çelur depozitën në datën 23.1.2004, në vlerën 1.355.000 lekë.

31. Transaksione bankare nga nëna e subjektit të rivlerësimit

31.1 Nga korrespondenca e Komisionit me bankat e nivelit të dytë u konstatua se nëna e subjektit, shtetasja A.LL, kishte kryer disa transaksione bankare, depozitime dhe tërheqje në llogarinë e saj bankare përgjatë viteve 2008 - 2009. Më konkretisht, në BKT⁶⁰ ishin kryer depozitimet *cash*, tërheqjet dhe transferimet sipas përshkrimit në tabelat vijuese.

Tabela nr. 2

Data	Vlera në euro	Përshkrimi i transaksioneve për depozitimet
10.3.2008	2,000	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
23.6.2008	10,000	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
3.7.2008	10,000	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
8.7.2008	10,000	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
26.8.2008	19,732	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
26.8.2008	288	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
29.8.2008	5,000	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
3.9.2008	6,200	Cash depozitë A.LL derdhje në depozitë
	63,220	

Tabela nr. 3

Data	Vlera në euro	Përshkrimi i transaksionit për tërheqje/transfertë
24.12.2008	10,184.50	Tërheqje, A.LL, paguar nga depozita
15.1.2009	20,000.00	Tërheqje, A.LL, tërhequr nga depozita
2.3.2009	20,000.00	Transfertë, A.LL kalim në llogari në favor të B. K. Ll
4.9.2009	11,728.72	Tërheqje, A.LL, tërhequr nga depozita kursime
4.9.2009	2,097.74	Tërheqje, A.LL, tërhequr nga depozita
	64,010.96	

31.2 Nga verifikimi përkatës rezultoi se përveç transfertës në emër të shtetasit B.LL, shumat e tërhequra në datën 4.9.2009 janë depozituar në një bankë tjetër, konkretisht, në Abi Bank, llogari në emër të nënës së subjektit. Më pas, shuma e akumuluar prej 13.200 euro është tërhequr në datën 7.11.2011.

31.3 Komisioni pyeti⁶¹ subjektin e rivlerësimit për burimin e krijimit të shumave të depozituara, si dhe i kërkoi të jepte shpjegime lidhur me këto veprime. Subjekti, në përgjigjen e dhënë për depozitimet e kryera nga nëna e saj, deklaroi se: “Kjo llogari bankare duhet të jetë hapur duke pasur si burim vetëm të ardhurat e siguruara nga aktiviteti tregtar i djalit të saj B.LL, i cili ka menaxhuar një agjenci turistike që nga viti 1998 ‘E.T’. Këtë aktivitet tregtar e ka ushtruar më pas si titullar i kësaj agjencie tek rruga ‘***’, aktivitet të cilin e ka formalizuar sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 27.3.2001. Gjithashtu, që nga muaji korrik i vitit 2007 ka menaxhuar një palestër”. Ndërsa për tërheqjet dhe transfertën, subjekti ka sqaruar se: “Nuk jam në dijeni të këtyre veprimeve bankare, por shpreh mendimin dhe bindjen time se këto shuma janë burim i punës së djalit të saj B.LL dhe destinacioni i këtyre shumave të tërhequra duhet të ketë qenë

⁶⁰Sipas shkresës nr. *** prot., datë 2.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶¹Pyetësor nr. 3, datë 23.11.2022.

vetëm në funksion të këtij aktivitetit tregtar si tek agjencia turistike, ashtu edhe tek palestera. Duke pasur si burim të vetëm të ardhurat e siguruara nga aktiviteti tregtar i B.LL, me të drejtë kjo shumë i është kaluar po atij tek llogaria bankare e tij. Nuk e di arsyen e tërheqjes së kësaj shume”.

31.4 Komisioni kreu hetim për të ardhurat e vëllait, për të parë mundësinë e tij financiare për krijimin e tyre, nisur nga fakti se subjekti ka deklaruar se burim krijimi i këtyre shumave të depozituara nga nëna janë të ardhurat e siguruara nga aktiviteti tregtar i vëllait të saj. Duke qenë se nëna është në të njëjtin trung familjar me subjektin e rivlerësimit, atëherë ajo përfshihet në kategorinë e personave të lidhur.

31.4.1 Nga hetimi rezultoi se:

i. Bashkia Shkodër⁶² ka informuar se subjekti “B.LL” ka qenë i regjistruar si biznes me NIPT ***, me aktivitet “shërbime komisionere për shitje biletash, palestër” dhe ka aplikuar për mbyllje të aktivitetit pranë Bashkisë Shkodër në datën 18.1.2010. Ky subjekt ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore deri në momentin e mbylljes së aktivitetit dhe ka deklaruar xhiron vjetore në tabelën vijuese.

Tabela nr. 4

Viti	Aktiviteti	Xhiro
2007	Shërbime komisionere	4,000,000
2008	Shërbime komisionere	4,000,000
2008	Palestër	1,700,000
TOTAL		9,700,000

ii. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër⁶³ ka informuar se tatimpaguesi B.LL, me NIPT ***, me administrator B. K. Ll. është regjistruar në datën 26.3.2004 me statusin ligjor “person fizik” dhe statusi aktual i tatimpaguesit është “pasiv” nga data 31.1.2011, me objekt aktiviteti “shërbime komisionere për shitje biletash, palestër, etj.”. Xhiroja dhe fitimi i deklaruar nga subjekti janë pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 5

Viti	Xhiro	Fitimi/humbja
2005	3,100,000	810,000
2006	4,000,000	-
2008	4,370,000	780,000
TOTAL	11,470,000	1,590,000

31.4.2 Nga informacioni i administruar nga Bashkia Shkodër dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër Komisioni konstatoi se nuk përputhej xhiroja e vitit 2008. Në përlllogaritjet e kryera për efekt të analizës financiare Komisioni u bazua në informacionin e administruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, pasi deklarimi në bashki ka qenë thjesht parashikim për xhiron vjetore.

31.4.3 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se vëllai i subjektit është administrator i shoqërisë “K.G” me NIPT ***. Nisur nga fakti se kjo shoqëri është regjistruar më 12.11.2009, Komisioni

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2022, e DPT-së, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.

nuk i ka përfshirë të ardhurat në analizë pasi janë jashtë periudhës për të cilën po hetohet. Depozitimet janë kryer gjatë vitit 2008 dhe, për këtë arsye, i gjithë informacioni i pasqyruar edhe më sipër është kufizuar deri në këtë vit.

31.4.4 Në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi, për shkak të funksionit të subjektit të rivlerësimit, me kompanitë⁶⁴ në zotërim nga vëllai i saj, Komisioni ka hetuar dhe nuk u konstatua asnjë rast⁶⁵ që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështje të çdolloj natyre (civile, penale, familjare, etj.) me palë ndërgjyqëse personat juridikë/fizikë në emër të vëllait.

31.4.5 Meqenëse vëllai i subjektit ka investuar në blerjen e një pasurie në vitin 2005, ku sipas subjektit ai nuk ka jetuar më me familjen e origjinës që prej dhjetorit të vitit 2004 dhe për këtë deklaram⁶⁶ ka depozituar kartelën e pasurisë në emër të vëllait, e cila daton 24.10.2005, Komisioni ka vlerësuar të analizojë të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar për periudhën 2005 – 2008, nisur edhe nga fakti se përpara kësaj periudhe nuk kishte të dhëna për të ardhurat e përfituara nga vëllai i subjektit.

31.4.6 Komisioni vlerësoi që për vitin 2007, meqenëse nuk ka të dhëna për fitimin e realizuar, ta përlllogarisë atë në masën 22% të xhiros, nisur nga mesatarja e atyre viteve për të cilët ka informacion. Ndërsa për vitin 2008, meqenëse depozitimet janë kryer deri në datën 3.9.2008, Komisioni vlerësoi që fitimin e vitit 2008 ta ndajë në mënyrë të barabartë për secilin muaj. Nga përlllogaritjet rezulton se fitimi i realizuar për vitet 2005 – gusht 2008 është në tabelën vijuese.

Tabela nr. 6

Viti	Fitimi në lekë
2005	810,000
2006	-
2007	880,000
Deri në gusht të vitit 2008	520,000
TOTAL	2,210,000

31.4.7 Nga sa më sipër, rezultoi se të ardhurat e përfituara nga fitimi i aktivitetit tregtar për periudhën 2005 – gusht 2008 janë në shumën 2.210.000 lekë. Komisioni konstatoi se kjo shumë nuk e mbulonte vlerën prej 63.220 euro të depozituar nga nëna e subjektit në periudhën mars - shtator 2008 dhe investuar në depozita.

31.4.8 Komisioni nuk kreu një analizë financiare të mirëfilltë për vëllain e subjektit, pasi vetëm me fitimin e aktivitetit duket se nuk mbulohej depozitimet.

31.4.9 Për sa më sipër, Komisioni, duke konstatuar se nuk provohej burimi i ligjshëm i depozitimeve dhe mungonte dokumentacioni për të provuar dhënien dhe marrjen e shumave mes nënës dhe vëllait të subjektit deri në fazën e mbylljes së hetimit administrativ, nuk e përfshiu si të ardhur vlerën 63.220 euro në analizën financiare, të kryer për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e saj.

31.4.10 Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu përlllogaritjet financiare⁶⁷, ku si rezultat i mospërfshirjes së shumës 63.220 euro si e ardhur konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj nuk kishin mundësi financiare për të krijuar këto depozita.

31.4.11 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni për këtë çështje i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e rezultatit, pasi dukej se: (i) nuk provohej burimi

⁶⁴Sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.12.2022, nga QKB-ja.

⁶⁵Sipas shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.1.2023, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁶⁶Në pyetësorin nr. 3, datë 23.11.2022.

⁶⁷Referohuni në tabelën nr. 11 në dokumentin e rezultateve të hetimit dhe analizës financiare në formatin *excel*.

i ligjshëm i shumës 63.220 euro nga aktiviteti tregtar i vëllai të subjektit; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj gjenden në pamundësi financiare në shumën 7.480.169 lekë për të pasur depozitat, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; (iii) ka mungesë dokumentacioni për të provuar dhënien dhe marrjen e shumave mes nënës dhe vëllait të subjektit; (iv) mbeteshin të paqarta arsyet e kryerjes së këtyre transaksioneve nga nëna e subjektit kundrejt pretendimit/shpjegimit të subjektit se këto shuma janë burim i punës së vëllait të saj dhe se destinacioni i këtyre shumave të tërhequra duhet të ketë qenë vetëm në funksion të këtij aktiviteti tregtar si tek agjencia turistike, ashtu edhe te palestra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

31.5 Lidhur me konstatimet e Komisionit subjekti ka parashtruar se në analizën financiare Komisioni ka mbajtur parasysh xhiron e deklaruar nga vëllai i saj për këto vite, duke sjellë në vëmendjen e Komisionit faktin që xhiroja e biznesit të shtetasit B.LL është llogaritur vetëm mbi bazën e përqindjes së komisionit në shitjen e biletave të udhëtimit sipas marrëveshjeve me kompanitë që e zhvillonin aktivitetin në Tiranë (“R.T” sh.p.k., “B-A” etj.). Subjekti ka shpjeguar se vëllai i saj ka qenë agjent shitjesh për këto kompani në qytetin e Shkodrës dhe biznesin e tij vëllai e zhvillonte me shitje biletash në arkën e agjencisë ose nëpërmjet transfertave bankare. Kjo shitje përmbante në vlerë monetare çmimin e plotë të biletës së udhëtimit dhe, për këtë arsye, qarkullimi monetar në biznesin e agjencisë së shtetasit B.LL ishte në vlera të konsiderueshme.

31.5.1 Subjekti ka sqaruar se vetëm për vitin 2008 kjo agjenci ka arkëtuar në “ProCredit Bank” shumën 466.870 euro. Kjo shumë është realizuar vetëm nëpërmjet bankës, pa llogaritur këtu vlerat monetare të realizuara e të qarkulluara *cash*. Nisur nga kjo situatë financiare e biznesit që vëllai i saj realizonte, kishte mundësi që herë pas here një pjesë të xhiros t’ia jepte hua nënës me qëllim që kjo e fundit ta depozitonte dhe të përfitonte interesa bankare si ndihmë ekonomike nga djali i saj.

31.5.2 Sipas subjektit, këto veprime janë bërë brenda vitit 2008 dhe burim i këtyre të ardhurave kanë qenë vetëm të ardhurat nga xhiroja e biznesit të shtetasit B.LL. Ky fakt provohet tërësisht me tërheqjen dhe destinacionin e këtyre parave, pasi rezultoi e provuar që në të njëjtën periudhë kohore, vëllai i saj ka realizuar një kontratë porosie për blerjen e një apartamenti me subjektin “E” sh.p.k., të cilit me transaksion bankar i ka paguar në datën 3.2.2009 shumën 20.000 euro, të cilën nëna e ka tërhequr nga banka në datën 15.1.2009. Po kështu, përsëri për llogari të shoqërisë “E” sh.p.k. është paguar edhe një kësht i dytë në shumën 20.000 euro, të cilën shtetasja A.LL ia ka transferuar djalit të saj B.LL në datën 2.3.2009 dhe, po në këtë datë, ky shtetas i ka kërkuar BKT-së transaksionin drejt shoqërisë “E” sh.p.k. Ky apartament nuk u arrit asnjëherë të finalizohet me kontratë shitblerjeje mes vëllait dhe subjektit ndërtues, por investimi prej 40.000 euro u destinua për blerjen e një tjetër ambienti ku vëllai i subjektit ushtron biznesin.

31.5.3 Lidhur me këto transaksione subjekti ka parashtruar se ajo dhe prindërit e saj nuk kanë investuar kurrë në blerje me shuma të tilla dhe nuk kanë pasur ndonjëherë në dispozicion të jetesës së tyre modeste vlera kaq të larta, duke analizuar faktet si vijon:

31.5.4 Në llogaritë bankare të subjektit tregtar “B.LL” që Komisioni disponon, provohet që lloji i aktivitetit tregtar të vëllait qarkullon shuma të mëdha monetare, të cilat akumuloheshin në llogarinë bankare të biznesit dhe rrinin aty (“flinin” është termi bankar) sipas marrëveshjeve (të cilat nuk i disponojnë sepse nuk kanë qenë të formalizuara me shkrim) që vëllai kishte me kompanitë – agjent i të cilëve ishte. Vëllai ka filluar veprimtarinë tregtare që në vitin 1995 dhe ka ushtruar vazhdimisht veprimtari në fushën e biznesit. Po kështu, edhe bashkëshortja e tij ka kryer disa punë dhe kanë pasur mundësi ekonomike të akumulojnë të ardhura, t’i investojnë ato dhe të gjenerojnë fitime nga puna e tyre. Vetëm për vitin 2008 agjencia ka pasur shumën 466.870 euro.

31.5.5 Sipas subjektit është e dukshme dhe bindëse që këto shuma nuk ishin investim financiar i familjes së saj, por origjina e tyre ishte nga xhiroja e agjencisë, të ardhurat nga biznesi dhe përdorimi i përkohshëm i tyre nga nëna e saj. Mbi marrjen dhe dhënien e shumave mes nënës dhe vëllait, subjekti ka parashtruar se ato janë kryer brenda marrëdhënies familjare ku ka dhe mbizotëron dashuria, respekti dhe besimi reciprok, si dhe destinacioni i shumave të tërhequra janë përsëri drejt djalit të saj, sikurse e ka provuar me dokumentacion.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

31.6 Trupi gjykues, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara në raport me shpjegimet e subjektit, lidhur me këtë çështje objekt vlerësimi çmon ta analizojë atë në situatat faktiko - ligjore dhe më konkretisht:

Lidhur me pozitën e subjektit për lidhje të mundshme me këto transaksione sipas ligjit nr. 84/2016

31.6.1 Në këtë drejtim, Komisioni hetoi lidhur me këto transaksione dhe kërkoi provueshmërinë e burimit të tyre, për sa kohë nëna e subjektit rezultonte në të njëjtin trung familjar dhe shfaqej si depozituese e këtyre shumave. Në analizë të pretendimeve të subjektit, shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, si dhe dokumentacionit të administruar lidhur me të ardhurat e siguruar nga punësimi dhe aktiviteti privat i vëllait të saj, trupi gjykues konstatoi se:

i. Vëllai i subjektit, shtetasi B.LL, sipas vërtetimit⁶⁸ të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 23.3.2000, rezulton se ka qenë përfaqësues i shoqërisë “A” sh.p.k. me NIPT ***, regjistruar më 26.5.1995, me objekt “shitje biletash”.

ii. ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror, me vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare⁶⁹ konfirmon se shtetasi B.LL ka qenë i siguruar për vitin 1998 në shoqërinë “A” dhe ka përfituar të ardhura në shumën 165.658 lekë *bruto*.

iii. Në llogarinë bankare të shtetasit B.LL në “Intesa Sanpaolo Bank”⁷⁰, për vitet 2000 - 2001 është kredituar në total shuma 12.521 euro nga “G. M. P...”, për të cilën subjekti ka sqaruar se vëllai i saj ka punuar me një projekt të huaj, për të cilin është paguar.

iv. Subjekti ka depozituar një çek në vlerën 10.800.000 lireta italiane ose e konvertuar në 737.856 lekë, për të provuar të ardhura nga punësimet e tij, por nuk identifikohet qëllimi dhe përfituesi.

v. Vëllai i subjektit ka regjistruar aktivitetin e tij privat në fushën e shërbimeve komisionere për shitje biletash me vendimin nr. ***, datë 27.3.2001, të gjykatës.

vi. ISSH Drejtoria Rajonale Shkodër, me vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare⁷¹ konfirmon se i siguruari B.LL për periudhën 2001 – 2008 ka realizuar 1.053.181 lekë, të ardhura *bruto*.

vii. Subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues për pagesat e kryera nga aktiviteti privat i vëllait për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, taksat apo tatim-fitimin e thjeshtuar në vite.

⁶⁸Depozituar nga subjekti i rivlerësimit në prapësime.

⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2023, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në prapësime.

⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2022, në dosjen e Komisionit.

⁷¹Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2023, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në prapësime.

viii. Bashkia Shkodër⁷² dhe DPT Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër⁷³ kanë informuar se “B.LL.” person fizik, me NIPT ***, ka realizuar qarkullim në vlerat sipas tabelës përmbledhëse vijuese.

Tabela nr. 7

Viti	Qarkullimi
2002	1,800,000
2003	2,200,000
2004	1,800,000
2005	3,100,000
2006	4,000,000
2007	4,000,000
2008	4,370,000
Total	21,270,000

ix. Vëllai i subjektit ka përfituar në vitin 2005 shumën 1.000.000 lekë nga shitja e pjesës së tij takuese për apartamentin e përfituar nga privatizimi.

x. Vetëm për vitin 2008 vëllai i subjektit ka depozituar në llogarinë e tij bankare në “ProCredit Bank” shumat 500.323 euro dhe 1.966.088 lekë.

xi. Nga gjurmimi i transaksioneve u provua destinacioni i tyre për investim në pasuri të paluajtshme, ku fillimisht është nënshkruar kontratë porosie për blerje apartamenti e, më pas, për një njësi. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 28.2.2009, nënshkruar mes sipërmarrësve “G” sh.p.k. dhe “E” sh.p.k. dhe porositësit B. K. LL., për blerjen e një apartamenti banimi me sip. 120 m². Çmimi i shitjes rezulton 54.000 euro. Rezultoi gjithashtu se likuidimi i kësaj kontrate është kryer nga vëllai i subjektit nëpërmjet sistemit bankar. Më konkretisht, ai ka paguar në datën 3.2.2009 shumën 20.000 euro në favor të shoqërisë “E” sh.p.k., me përshkrimin “kalim fondi për likuidim blerjeje apartamenti nga B.LL”. Kjo vlerë korrespondon me shumën 20.000 euro, të cilën nëna e ka tërhequr nga llogaria e saj në datën 15.1.2009. Po kështu, përsëri për llogari të shoqërisë “E” sh.p.k. ai ka paguar edhe këstin e dytë në shumën 20.000 euro, datë 2.3.2009, nga llogaria e tij në BKT. Kjo shumë, po atë datë, pra 2.3.2009, i është transferuar nga nëna e tij, znj. A.LL.

31.6.2 Të gjitha faktet e sipërcituara provojnë destinacionin e shumave të depozituara dhe më pas të tërhequra/transferuara nga nëna e subjektit të rivlerësimit të djali i saj, me burim krijimi nga të ardhurat e këtij të fundit, për të cilin u provua që ka qenë i punësuar që prej vitit 1995, ka siguruar të ardhura nga punësimi, ka pasur aktivitet privat dhe, për pasojë, ka realizuar fitim nga aktiviteti i tij tregtar, si dhe qarkullimi nga ky aktivitet ka qenë në shuma të konsiderueshme.

31.6.3 Trupi gjykues situatën faktike të kësaj çështjeje e çmon thelbësisht mbi faktin se nuk u evidentua asnjë rrethanë/fakt/*indicie* që lidh subjektin e rivlerësimit me këto transaksione, pasi përgjatë procesit nuk u provua asnjë veprim i subjektit, si tërheqje apo depozitim i ndonjë shume, investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, shpenzim apo përfitim nga këto të ardhura. Nën këto fakte, trupi gjykues çmon se nuk ka dyshime për pasuri të fshehur nga ana e subjektit, deklarime të rreme apo evidentim të ndonjë rrethane që mund të pamundësonte hetimin e Komisionit lidhur me kontrollin dhe verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit.

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2022.

⁷³Shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2022.

Në lidhje me marrëdhënien e nënës dhe vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe impaktit të kësaj marrëdhënieje në pozitën e subjektit

31.7 Trupi gjykues për këtë çështje, paraprakisht, evidentoi faktin se sipas certifikatës⁷⁴ familjare nr. ***, datë 7.12.2022, të vëllait të subjektit, ky i fundit dhe familja e tij (bashkëshortja dhe dy fëmijët) ishin shkëputur nga familja e origjinës më 5.10.2016. Në këto kushte, në fazën e hetimit, Komisioni konstatoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk bënte pjesë në rrethin e personave të lidhur⁷⁵, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera privatë, pasi nuk kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në datën 8.10.2016. Po ashtu, po në këtë drejtim, Komisionit, nga hetimi administrativ i kryer dhe dokumentacioni i administruar, i rezultoi se: (i) sipas certifikatës familjare nr. ***, datë 7.12.2022, vëllai është shkëputur nga familja e origjinës në datën 5.10.2016; (ii) vëllai i subjektit ka blerë një apartament banimi në vitin 2005 sipas kontratës⁷⁶ së sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2005 dhe vërtetimit hipotekor datë 24.10.2005; (iii) kontrata e energjisë elektrike për apartamentin e blerë në vitin 2005 është lidhur më 28.4.2006; (iv) subjekti ka deklaruar⁷⁷ se vëllai i saj *de facto* nuk ka banuar me familjen që prej dhjetorit të vitit 2004; (v) vëllai i subjektit është martuar⁷⁸ në datën 14.1.2008, shtuar si familje me fëmijët e lindur në datat 22.8.2008 dhe 3.1.2011. Këto rrethana faktiko-ligjore vlerësohen nga trupi gjykues si të tilla që përcaktojnë faktin se vëllai i subjektit nuk kualifikohet si person tjetër i lidhur me të.

31.7.1 Nga ana tjetër, Komisioni evidenton faktin se nëna është person i lidhur me subjektin pasi është në të njëjtin trung familjar me të dhe se ka kryer transaksione me shumat e depozituara, nga ku janë përfiturar edhe interesa në shumën 230.538 lekë, për të cilat subjekti deklaroi se ky veprim është kryer nga vëllai me qëllimin për të ndihmuar nënën. Trupi gjykues konstaton se këto rrethana duket se krijojnë një raport mes vëllait të subjektit (i cili për faktet e përshkruara në pikën 31.7 nuk kualifikohet si person tjetër i lidhur nën sferën e ligjit nr. 84/2016) me personin e lidhur (nënë), porse kjo marrëdhënie rezulton pa përfshirje të subjektit, pasi nga hetimi nuk u evidentua ndonjë lidhje e saj me ta. Në këto kushte, vlerësohet se nuk u krijua një bazë e qenësishme faktiko-ligjore që të mund të marrë një kualifikim ligjor të tillë për ta vendosur subjektin nën detyrimin e deklarimit dhe justifikimit të burimit të krijimit të tyre në nivelin e kërkimit të nenit 32, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016.

31.7.2 Kjo çmuarje e trupit gjykues vlerësohet e tillë edhe në interpretim të dispozitave ligjore dhe konkretisht, nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të cilët parashikojnë shprehimisht sa vijon: “[...] ‘Persona të tjerë të lidhur’ janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me **subjektin e rivlerësimit**, komisionerin, gjyqtarin ose Komisionerin Publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi [...]. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] 4. **Subjekti i rivlerësimit** dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit,

⁷⁴Depozituar me pyetëSORIN nr. 3, datë 23.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁵Sipas nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se: “Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit..., si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”. Në nenin 3, pika 12 e ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: “Periudha e rivlerësimit është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij”. Sipas këtij ligji dhe referuar pikës 3 të nenit 41, kjo periudhë përkon me 3 vitet e fundit nga hyrja në fuqi e tij. Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016. Më tej, në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

⁷⁶Referohuni pyetëSORIN nr. 5, datë 4.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁷Në pyetëSORIN nr. 3, datë 23.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁸Referohuni pyetëSORIN nr. 7, datë 18.1.2023.

huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

31.7.3 Po ashtu, në vlerësimin e situatës faktiko-ligjore, trupi gjykues i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku me anë të vendimeve nr. 21/2020 (JR), datë 10.9.2020, nr. 8/2020, datë 25.6.2020, nr. 4/2021, datë 9.2.2021 dhe nr. 33, datë 9.1.2020, etj. janë trajtuar/arsyetuar dispozitat ligjore mbi rrethanat e kualifikimeve të personave të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 8/2020..., paragrafi 38 arsyeton: *“Në rrethanat faktike konkrete trupi gjykues vlerëson se nuk u provua përfshirja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e subjektit të rivlerësimit në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues çmon se provat e administruara në gjykim provuan mjaftueshëm mungesën e marrëdhënies së interesit të subjektit të rivlerësimit me babain e saj, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016”.*

31.7.4 Në analizë të dispozitave ligjore të sipërcituara të ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues çmon se në çështjen objekt vlerësimi, nuk u evidentuan elemente që lidhin subjektin e rivlerësimit me nënën e saj dhe/ose vëllain në këtë marrëdhënie të shfaqur në formën e huas, dhurimit apo çdo interes pasuror. Nën këtë analizë, niveli i provueshmërisë së këtyre transaksioneve, i konstatuar pa lidhje në çfarëdolloj forme me subjektin e rivlerësimit, nuk impakton pozitën e saj dhe, si e tillë, nuk mund të barazohet me detyrimin që vetë subjekti/et kanë sipas ligjit nr. 84/2016, në raport me personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur. Trupi gjykues çmon se çdo logjikë arsyetimi ndryshe do të ishte disproporcionale në përmbushje të qëllimit të ligjit në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

31.7.5 Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se, pavarësisht se Komisioni kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për provueshmërinë e burimit të këtyre shumave për lidhje të mundshme të subjektit me to, duke qenë se përgjatë gjithë procesit për këtë subjekt nuk u evidentua ndonjë dyshim lidhur me burimin e krijimit ku të përfshihej subjekti i rivlerësimit apo për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, deklarim të rremë, si dhe në mungesë të çdo informacioni negativ nga organet ligjzbatuese për figurën e saj në çështjen objekt vlerësimi, nuk ka rrethana të tilla që afektojnë procesin e rivlerësimit të subjektit.

Vlerësimi tërësor i pasurisë

31.8 Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Arta Llazari ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh se pasaktësitë në deklarim dhe mungesa e burimeve të ligjshme në një vlerë totale prej 744.297 lekësh, e shpërndarë në 2 vite, për blerjen e pasurive në momentin e krijimit të tyre, si dhe për kryerjen e shpenzimeve, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

32. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të

Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, të KDZH-së, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arta Llazari.

32.1 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arta Llazari.

Hetimi i Komisionit

32.2 Nga informacioni i përditësuar⁷⁹ në mënyrë të përsëritur nga organet ligjzbatuese nuk rezultuan të dhëna të tjera lidhur me kriterin e kontrollit të figurës.

32.3 Komisioni, në vijim si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

32.4 Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk evidentoi rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Arta Llazari ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

33. Raporti për analizimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

33.1 Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (ii) 5 akteve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së, pas të cilit është konkluduar në: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

33.2 Raporti i vlerësimit profesional në analizë të gjetjeve, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikës dhe integritetit të subjektit.

Analiza e gjetjeve

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.4.2022 dhe nr. *** prot., datë 21.11.2022.

33.3 Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”, ndërsa pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

33.3.i Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë apo nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Në tria dokumentet ligjore dhe në tri nga dosjet gjyqësore të vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet administrativo-penale i kushton rëndësi shqyrtimit të kriterëve për përjashtimin e gjyqtarëve nga gjykimi dhe rrethanave që përlligjin ose jo arrestimin e personave nën hetim, nëse masa e sigurimit të kërkuar nga organi i prokurorisë i përshtatet ose jo kërkesave dhe kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji. Në dy dokumentet e tjera ligjore të vëzhguara, të hartuara si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, është konstatuar se është pasqyruar saktë dhe në mënyrë të detajuar mendimi i këshilltarit ligjor i argumentuar lidhur me ligjin e zbatueshëm material dhe procedural civil, si dhe propozimi për zgjidhjen konkrete të çështjes. Karakteristikë e opinionëve të hartuara prej këshilltares ligjore Arta Llazari është pasqyrimi i detajuar i rrethanave të çështjes, pretendimet parashtruar para Gjykatës Kushtetuese, si dhe analiza e çështjes në të cilën evidentohen pretendimet e ngritura nga kërkuesi në frymën e gjykimit në nivel kushtetues prej subjektit, bazuar në normat kushtetuese, ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në praktikën e kësaj gjykate.

Gjyqtarja Arta Llazari ka njohuri të procedurave të gjykimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet e përzgjedhura dhe tri nga dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 2 prej tyre. Në të dyja rastet, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, ndërsa në katër rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët. Është evidentuar se përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren Arta Llazari rezulton se janë paraqitur gjithsej 7 ankesa (6 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së, ku 6 ankesa të vitit 2014 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, 1 prej të cilave me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 5 prej tyre si ankesa të përsëritura. Një ankesë e vitit 2016 është verifikuar për mosrespektim formal ligji dhe është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional të gjyqtarës Arta Llazari.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Arta Llazari përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi, janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e

drejtshkrimin në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor dhe i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shihni dokumentin 2 dhe dosjet 1 dhe 2). Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsytimit të vendimit te thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsytimin e tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët.

Gjithashtu, tek tri dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsytimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

33.3.ii Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 24.4.2015 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

Ajo ka deklaruar se në vitin 2014 i janë caktuar dhe ka përfunduar 32 çështje, nga të cilat 21 kërkesa kanë konkluduar me moskalim në seancë plenare dhe 6 kërkesa me vendime përfundimtare. Ajo ka deklaruar se këto të dhëna i referohen çështjeve të caktuara për gjyqtarin relator, pranë të cilit ka punuar si këshilltare gjatë kësaj periudhe, pasi këshilltari ligjor ushtron veprimtari ndihmëse dhe nuk ka funksion vendimmarrës. Këto të dhëna statistikore janë të deklaruara nga vetë subjekti dhe nuk janë verifikuar nga Inspektorati. Ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Kushtetuese, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën edhe dy dokumentet ligjore, rezulton se këshilltarja ligjore Arta Llazari ka hartuar akte opinione për 42 çështje me natyrë kushtetuese, nga të cilat 8 pranime dhe 34 moskalime.

Duke iu referuar nenit 6/1 të rregullores së brendshme të Gjykatës Kushtetuese “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”, për sa i përket aspektit kohor, këshilltari ligjor i gjyqtarit relator duhet të vërë në dispozicion të gjyqtarëve të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese materialin e përgatitur prej tij të paktën 2 ditë përpara seancës. Në analizën e këtyre të dhënave, për të konkluduar mbi aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë duhet evidentuar edhe fakti se kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për këshilltarin ligjor të Gjykatës Kushtetuese në aspektin sasior. Nisur nga analiza më sipër, arrihet në konkluzionin se nga këshilltarja ligjore është zbatuar afati kohor, pasi në të dyja rastet opinionet përmbanin datën e relatimit të tyre. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit Arta Llazari, në periudhën tjetër të rivlerësimit, 25.4.2015 – 8.10.2016, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për 18 muaj, duke kryer çdo proces që lidhet me çështjet gjyqësore e deri në dhënien e vendimit, duke përcaktuar fushën e të drejtës civile e penale. Ajo ka deklaruar se

gjatë 18 muajve të 3 viteve të fundit i janë caktuar si gjyqtare gjithsej 847 çështje, ka përfunduar gjithsej 712 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 135 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 84%.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Arta Llazari ka përfunduar gjithsej 533 çështje gjyqësore, nga të cilat 327 çështje civile (139 civile me palë kundërshtare, 46 çështje familjare, 12 urdhra mbrojtjeje, 29 kërkesa civile dhe 101 urdhërkzekutime) dhe 206 çështje penale (186 masa sigurimi, 10 çështje penale themeli dhe 10 çështje administrativo-penale). Sipas pikës 3, germa “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtare.

Nga analiza e tri dosjeve të përzgjedhura me short në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Arta Llazari ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 ditë deri në 3 muaj e 14 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje civile, pasaktësi e regjistrorit, e shqyrtuar në 6 seanca, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimit të padisë, vendim i cili është ankimuar dhe është lënë në fuqi. Në dosjen e tretë, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 3 muaj e 12 ditë. Në tri dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimit për çështjen e parë, masë sigurimi penale është 2 ditë, për çështjen e dytë kërkesë administrativo-penale është 20 ditë, ndërsa për çështjen e tretë, civile me palë kundërshtare, afati është 7 muaj e 20 ditë, jashtë afatit 6-mujor. Në dy nga tri dokumentet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Arta Llazari ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 2 çështjet civile të vëzhguara ajo ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore. Veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në 2 çështjet civile, gjykimet kanë përfunduar me 4 deri 6 seanca, ndërsa çështja administrativo-penale e vëzhguar, që lidhet me caktimin e masës së sigurimit personal, është përfunduar me 1 seancë.

Konkretisht, janë vëzhguar 11 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë të gjitha produktive. Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar i palëve e deri te shpallja e vendimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Në dy dokumentet e përzgjedhura me short në Gjykatën Kushtetuese rezultoi se mendimi i këshilltarit ligjor është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse në formën e opinionëve. Nga ana tjetër, duhet theksuar se në opinionet e shortuara identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi

aktet kanë datën e hartimit. Gjithashtu, të dy opinionet janë me nënshkrim të subjektit të rivlerësimit. Nga vëzhgimi i tri dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile dhe ato penale. Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet e seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje rezultojnë se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përskrimet për veprimet procedurale të kryera, gjithashtu të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore, kur janë mbajtur me regjistrime audio, por në raste të tjera edhe nga gjyqtarja, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor në formatin letër dhe në atë të regjistruar audio dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në dy raste që është konstatuar vonesë rezulton se në procesverbal është dokumentuar shkaku i vonesës së çeljes së seancës gjyqësore si “*zgjatja tej parashikimit të seancës së mëparshme*” dhe “*çelet me vonesë për shkak të zgjatjes së seancave të tjera gjyqësore*”. Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndër gjyqësore e më pas aktet e gjykatës. Gjithashtu, ato rezultojnë edhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

33.3.iii Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtarja Arta Llazari ka marrë titullin “Jurist” nga universiteti “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër, në datën 31.7.1997 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2001. Fillimin në detyrë e ka me Dekretin Nr. ***, datë 15.9.2000, të Presidentit të Republikës, kur është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe me Dekretin Nr. ***, datë 2.10.2011, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe, më pas, me vendimin nr. ***, datë 11.10.2003, të KLD-së është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Znj. Llazari i është miratuar leja për të shërbyer si këshilltare në Gjykatën Kushtetuese me vendimin nr. ***, datë 14.11.2011, të KLD-së deri kur me vendimin nr. ***, datë 29.4.2015, ajo është rikthyer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Arta Llazari. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Arta Llazari dhe nga pesë 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Arta Llazari. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Arta Llazari nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

33.3.iv Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Arta Llazari komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtares dhe as kërkesa të vetë gjyqtares për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Arta Llazari për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 6 nga 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 1 seminar me temë “E drejta administrative”, i zhvilluar më 1 - 4 korrik 2014. Lënda e trajnimit ku ajo ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë në përbërje të dhomave civile e penale.

Subjekti i rivlerësimit Arta Llazari ka deklaruar në formular se ka marrë pjesë në tri aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, por që nuk përfshihen në periudhën e rivlerësimit të 3 viteve të fundit.

C/1. Rivlerësimi profesional nga Komisioni

33.4 Komisioni ka administruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer si burim për kryerjen e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit. Nga vlerësimi i tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të shortuara, duket se nuk evidentohen *indicie* për subjektin e rivlerësimit në kuptim të kriterit profesional.

33.5 Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të miratuar nga KLGJ-ja; dhe (ii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

33.6 Sa i përket analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe Grupit të Punës në raportin e tij të vlerësimit, në tërësi nuk i rezultuan problematika në lidhje me gjykimin e zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit në të tria dokumentet ligjore, të llojit “vendim gjyqësor”, si dhe në pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short.

33.7 Nga hetimi i Komisionit për 8 dosjet e analizuara, rezultoi se në 2 raste vendimarrjet e subjektit janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku kjo e fundit ka lënë në fuqi vendimet e ndërmarra nga ana e saj, ku kjo e fundit ka lënë në fuqi vendimet e ndërmarra nga ana e saj, një vendim i saj nuk është ankimuar, dy raste janë relacione të hartuara nga subjekti në funksionin si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa për dosjet që u përkasin çështjeve të përzgjedhura nga vetë subjekti nuk rezultuan të dhëna për statusin e tyre.

33.8 Në vijim, nga verifikimi i dosjeve, pasqyruar në raportin e KLGJ-së, Komisioni konstatoi se: (i) për çështjen që i përket⁸⁰ vendimit civil nr. ***, datë 1.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka tejkalim të afatit 6-mujor të gjykimit, e konkretisht me 1 muaj e 6 ditë vonesë; (ii) për çështjen që i përket⁸¹ vendimit nr. ***, datë 15.12.2015, dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është depozituar në kryesekretari⁸² 22 ditë pas shpalljes, pra 12 ditë jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile; (iii) për çështjen që i përket⁸³ vendimit nr. ***, datë 25.9.2015, dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është depozituar⁸⁴ në kryesekretari 19 ditë pas shpalljes, pra 9 ditë jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

33.9 Komisioni, për sa i rezultoi më sipër, i kërkoi subjektit të jepte shpjegime, si dhe të qartësonte statusin ligjor të çështjeve të përzgjedhura nga ana e saj.

33.10 Subjekti në lidhje me statusin ligjor të vendimeve të marra prej saj dhe të depozituara përgjatë përgatitjes së raportit të vlerësimit, së bashku me parashtrimet ka depozituar shkresën nr.*** prot, datë 06.02.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku konfirmohet se të tre vendimet e saj kanë mbetur në fuqi.

33.11 Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar, nuk vëren problematika në lidhje me rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

33.12 Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me kohëzgjatjen e hetimit, për çështjen që i përket⁸⁵ vendimit civil nr. ***, datë 1.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ku, ndër të tjera, u vërejt se ka tejkalim të afatit 6-mujor të gjykimit, me 1 muaj e 6 ditë vonesë. Më konkretisht, subjekti ka qartësuar se brenda periudhës 7 muaj e 6 ditë është përfshirë edhe leja e zakonshme, e cila është parashikuar në ligj dhe që nuk duhej përfshirë në përlllogaritje, pasi çështja ishte regjistruar më 23.7.2015. Subjekti, në mbështetje të shpjegimit të saj, ka referuar ligjin e kohës nr. 9877/2008, por edhe ligjin nr. 96/2016.

Po ashtu, subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të saj për të provuar kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes, ka qartësuar edhe faktin se paditësja ka qenë e moshuar dhe me probleme shëndetësore dhe se për këtë shkak ajo ka marrë në konsideratë edhe kohën e caktimit të seancës nga seanca.

33.13 Trupi gjykues, në referencë të parashikimit ligjor⁸⁶, pra duke përlllogaritur kështu në afatet e gjykimit edhe periudhën e kryerjes së lejes vjetore, në referencë të kohës së regjistrimit të padisë, si dhe kohës në të cilin është ndërmarrë vendimi gjyqësor, konkludon se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, nuk rezulton që çështja të jetë gjykuar në tejkalim të afatit 6-mujor.

33.14 Në lidhje me konstatimet e vonesave në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara që i përkasin pesë dosjeve të shortuara, më konkretisht, për një të dorëzuar 12 ditë në tejkalim të afatit 10-ditor, sikurse parashikon neni 308 i Kodit të Procedurës Civile dhe dosja tjetër rezultoi e dorëzuar me 9 ditë vonesë, subjekti ka shpjeguar se kjo situatë është kushtëzuar vetëm nga ngarkesa e punës për periudhën përkatëse, nga fakti se vendimet gjyqësore ajo i ka konsideruar si akte që duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të detajuara, ku

⁸⁰Referohuni dokumentit nr. 3 tek çështjet e përzgjedhura që i përkasin vendimit civil nr. ***, datë 1.3.2016.

⁸¹Referohuni dosjes nr. 2 tek çështjet e shortuara që i përkasin çështjes civile nr. *** regj., datë 2.9.2015.

⁸²Depozituar në datën 6.1.2016.

⁸³Referohuni dosjes nr. 1 tek çështjet e shortuara që u përkasin çështjes civile nr. *** regj., datë 11.6.2015.

⁸⁴Depozituar në datën 14.10.2015.

⁸⁵Referohuni dokumentit nr. 3 tek çështjet e përzgjedhura që u përkasin vendimit civil nr. ***, datë 1.3.2016.

⁸⁶Neni 24 i ligjit nr. 9877/2008, të drejta dhe përfitime për shkak të detyrës, parashikonte: "2. ...leja vjetore bëhet në muajin gusht".

duhet të pasqyrohen të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, aktet e paraqitura prej tyre, si dhe analiza ligjore e gjykatës, etj.

33.15 Trupi gjykues, pas dhënies së shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për këto dy raste të veçuara nuk vlerëson ndonjë problematikë që mund të ndikojë në rivlerësimin profesional të saj.

Të tjera

33.16 KLGJ-ja nuk ka konfirmuar propozim/e për masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit përgjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

33.17 Komisioni ka verifikuar lidhur me ekzistencën e materialeve hetimore në ngarkim të subjektit, për të cilën rezultoi se janë regjistruar dy materiale hetimore e specifikisht:

33.17.i Dosja⁸⁷ nr. *** pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilën rezultoi se është marrë vendim i mosfillimit datë 16.6.2020.

33.17.ii Dosja⁸⁸ që i përket kallëzimit penal nr. ***, depozituar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilën me vendimin e kësaj prokurorie, datë 26.5.2020 është vendosur mosfillimi i hetimeve. Ky material hetimor lidhet edhe me denoncimin e shtetasit N.M trajtuar në vijim tek pjesa e denoncimeve.

33.18 Sa më sipër, Komisioni⁸⁹ e ka pyetur subjektin lidhur me statusin ligjor për këto kallëzime penale dhe i ka kërkuar ta vërtetojë atë duke depozituar dokumentacion provues.

33.19 Subjekti, në përgjigje të këtij pyetësi, lidhur me statusin ligjor të kallëzimit penal nr. *** pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka depozituar vendimin nr. ***, datë 30.9.2020, të kësaj gjykate, i cili ka vendosur mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, viti 2020, nga ku rezultoi se ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.2.2021.

33.20 Ndërsa, lidhur me statusin ligjor të kallëzimit penal nr. *** depozituar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilin rezultoi se është marrë vendimi i mosfillimit në datë 16.6.2020, subjekti nuk kishte depozituar dokumentacion provues.

33.21 Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte statusin ligjor dhe të depozitonte dokumentacion provues lidhur me këtë kallëzim.

33.22 Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 14.4.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës, i cili rezultoi të ketë lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhënë mbi vendimin e mosfillimit të vendosur nga organi i akuzës.

C/2. Mbi denoncimet e depozituara pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit

34. Rezultoi se pranë Komisionit janë regjistruar 25 denoncime për subjektin e rivlerësimit. Këto denoncime janë administruar dhe vlerësuar nga Komisioni në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, të cilat paraqiten të trajtuara si vijon: nga 25 denoncime të administruara pranë Komisionit, 11 prej tyre rezultuan përsëritje nga të njëjtët denoncues me tipologji të njëjtë problematike, objekt denoncimi, dhe 1 rast është material në formën e prapësimeve të dërguara nga gjyqtarja I.K, të cilat lidhen me denoncimin nr. 4. Pra, denoncime të trajtuara janë 14 raste.

34.1 Denoncim⁹⁰ i shtetasit K.G

⁸⁷Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁸⁸Kthim përgjigjeje nr. *** prot., A. D., datë 28.10.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁸⁹Pyetësor nr. 5, datë 5.1.2023.

⁹⁰Me kërkesë nr. *** prot., datë 23.11.2017.

a. Rezultoi se denoncuesi, në cilësinë e administratorit të O sh.a., denoncon disa gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ndër ta është edhe subjekti i rivlerësimit. Referuar materialit të këtij denoncimi vërehet se në emër të subjektit të rivlerësimit referohet çështja civile nr. ***, datë 31.5.2017, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku denoncuesi shprehet se padia e paditësit është pa objekt, me anë të së cilës pretendon konstatimin e ekzekutimit me vonesë të vendimit të dhënë nga ana e saj. Po ashtu, duket se ky denoncues paraqet pretendime për ngritje të padisë pa objekt, pasi ky pretendim ka qenë i ngritur në një padi tjetër me të njëjtin objekt, për të cilin subjekti ka dhënë vendimin nr. ***, datë 6.6.2016.

b. Komisioni, lidhur me pretendimet e ngritura nga denoncuesi sa i takon vendimit nr. ***, datë 31.5.2017, konstaton se ai parashtron veprime të palëve ndërgjyqëse të ndërlidhura me padi të tjera dhe se ngritja e padisë me objekt “konstatimin e ekzekutimit me vonesë të vendimit” është pa objekt. Po ashtu konstatohet se denoncuesi ka ngritur këtë pretendim edhe për subjekte të tjera, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës, edhe pse e referon këtë pretendim.

c. Komisioni lidhur me pretendimet e denoncuesit i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila në qëndrimin e saj ka sqaruar se vendimi gjyqësor i përket një tjetër subjekti. Subjekti për të provuar këtë fakt ka depozituar fletën e regjistrimit.

ç. Nga verifikimi i dokumentit të depozituar provohet se gjyqtar i çështjes nuk ka qenë subjekti i rivlerësimit. Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë problematikë ndaj subjektit të rivlerësimit.

34.2 Denoncim⁹¹ i shtetasit GJ.SH

a. Shtetasi GJ.SH ka denoncuar subjektin e rivlerësimit, duke ngritur pretendimin se në vendimin nr. ***, datë 13.7.2016, me objekt “sigurim padie, vendosje e masës së ndalimit të veprimeve, kalimit mbi pasurinë me nr. ***, z. k. ***, Shkodër, në pronësi”, të kërkuesit, përveçse ka treguar njëanshmëri në vendim, ka referuar në fund të vendimit në pjesën urdhëruese (dispozitiv) se nuk lejohet ankimi kundër këtij vendimi. Denoncuesi nuk i ka bashkëlidhur ndonjë dokument provues këtij denoncimi.

b. Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁹², ku nga verifikimi i akteve të administruara në të ka konstatuar se denoncuesi përfaqësohet me avokat, si dhe subjekti në vendimmarrjen e saj u është referuar fakteve provuese, duke arsyetuar bazuar në nenin 312 të Kodit Civil.

c. Rezulton se subjekti në vendimin e saj arsyeton se kjo padi duhet të kishte për objekt “pushimin e cenimit dhe ndalimin e kalimit nga personi i tretë dhe mjeteve në përdorim” mbi pronën e kërkuesit me nr. pasurie ***, nga i padituri. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka vlerësuar duke arsyetuar se vënia e masës së sigurimit të padisë mbi pasurinë është e pajustificuar ligjërisht dhe e paprovuar faktikisht, duke e vendosur për rrjedhojë rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga pala kërkuese.

ç. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se subjekti i ka mohuar të drejtën e ankimit pasi tek pjesa e dispozitivit ka referuar se kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi, Komisioni ka konstatuar se subjekti në vendimin e saj është bazuar në dispozitat ligjore, specifikisht nenet 202 - 210⁹³ të Kodit të Procedurës Civile.

d. Lidhur me këtë çështje, Komisioni konstaton se neni 209 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: “...vetëm vendimet të cilat pranojnë, ndryshojnë ose heqin masën e sigurimit të

⁹¹ Me kërkesë nr. *** prot., datë 16.1.2018.

⁹² Shkresë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me të cilën ka përcjellë kopje të dosjes me nr. *** prot., datë 3.11.2022.

⁹³ Neni 209 (kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit të sipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë).

padisë, mund të ankimohen nëpërmjet ankimit të veçantë". Në këtë dispozitë nuk rezulton parashikim ligjor lidhur me ankimin kundër vendimit "për refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë", pra nëse do të lejohet ankim i veçantë kundër këtij vendimi.

dh. Gjithashtu, Komisioni konstaton se referuar praktikës gjyqësore të vendimeve nr. ***, datë 17.4.2007 dhe nr. ***, datë 8.5.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ky i fundit është shprehur/unifikuar në këtë çështje, duke i trajtuar këto vendime si "vendime të ndërmjetme", referuar nenit 470 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi, së bashku me të, vendimin përfundimtar.

e. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit sa i takonte çështjes së mosreferimit të së drejtës së ankimit së bashku me vendimin përfundimtar në dispozitivin e vendimit nr. ***, datë 13.7.2016, si dhe të qartësonte statusin ligjor të çështjes së themelit për këtë rast.

ë. Subjekti në qëndrimin e saj ka sqaruar se kjo kërkesë nuk është shoqëruar me padi themeli dhe, për pasojë, pasqyrimi i mosushtrimit të së drejtës ankimore në vendimin e mospranimit është i drejtë.

f. Subjekti ka depozituar praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2023.

g. Trupi gjykues e konsideron shpjegimin e subjektit të drejtë dhe të bazuar në ligj. Ky konkluzion bazohet në informacionin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, depozituar me shkresë nga subjekti, ku thuhet se, përveç kërkesës për sigurim padie në këtë gjykatë nuk ka pasur të regjistruar një padi me këto palë ndërgjyqëse. Pra, për sa kohë nuk rezulton e depozituar një padi themeli, nuk mund të ketë as edhe një vendim përfundimtar, me të cilin pala ndërgjyqëse mund të ankohet mbi refuzimin e kërkesës së sigurimit të padisë. Po ashtu, në vendimin e mospranimit të sigurimit të padisë, rezulton i pasqyruar fakti se kërkuesi nuk ka konfirmuar depozitimin e padisë së themelit me një objekt të ndryshëm nga ai në shqyrtim. Pra, në kushtet e mospërmbushjes së kërimit të nenit 202 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, mungesa e paraqitjes së padisë së themelit bën të pamundur ankimin e kërkesës së refuzimit të sigurimit të padisë, së bashku me vendimin përfundimtar dhe, për pasojë, pasqyrimi i të drejtës ankimore së bashku me vendimin përfundimtar nuk vlerësohet e bazuar në ligj. Në ndryshim nga ky rast, është lejueshmëria e ankimeve të veçanta (sipas nenit 209 të këtij Kodi), e cila ushtrohet kur pranohet kërkesa për sigurim padie apo zëvendësohet ajo. Nën këtë rrethana, trupi gjykues konkludon se në çështjen objekt vlerësimi nuk identifikohen mangësi që cenojnë kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34.3 Denoncim⁹⁴ i shtetases B. M. H.

a. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. ***, datë 21.11.2018, me objekt "përfundimin e gjyqtares I.K nga gjykimi i çështjes civile konstatim i pavlefshmërisë absolute të testamentit nr. ***, datë 25.4.2013", ka dhënë një vendim të njëanshëm dhe nuk ka treguar profesionalizëm në këtë vendimmarrje. Denoncuesja pretendon se gjyqtarja në këtë gjykim, në kundërshtim të plotë procedural, pa shpallur datën e gjykimit, kryen një gjykim pa praninë e palëve me dyer të mbyllura.

b. Komisioni ka kërkuar⁹⁵ kopje të dosjes gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku konstatohet mospranimi i kërkesës së paraqitur nga kërkuesja/paditësja për përfundimin e gjyqtares I.K nga gjykimi i çështjes. Nga hetimi rezultoi se subjekti, referuar nenit 74/4 të Kodit të Procedurës Civile, arsyeton se kërkesa duhet të përmbajë shkaqe ligjore të përfundimit dhe dokumentacion provues. Subjekti arsyeton se kërkuesja me kërkesën e paraqitur pranë kësaj gjykate nuk ka përmbushur as minimumin e këtij parashikimi ligjor të Kodit të Procedurës

⁹⁴ Me kërkesë nr. *** prot., datë 5.12.2018.

⁹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2022.

Civile. Në parashtrim të këtyre fakteve në arsyetimin e saj, subjekti ka vendosur mospranimin e kërkesës si të paplotë, të paqartë dhe të pambështetur në prova.

c. Komisioni, lidhur me këtë pretendim të denoncuesit, konstaton se në nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, parashikohet se: *“Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar”*.

ç. Komisioni, pas analizimit të akteve në dosje, konstatoi se pretendimet e denoncueses nuk qëndronin dhe se nuk identifikoheshin fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34.4 Denoncim⁹⁶ i shtetasit G.Y, për të cilin në vijim ka paraqitur edhe prapësimet⁹⁷ e subjektit znj. I.K të lidhura me padinë që ky denoncues ka ngritur ndaj znj. K. dhe subjektit të rivlerësimit.

a. Rezulton se ky denoncues me cilësinë e palës paditëse ka paraqitur në vitin 2018 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesëpadinë, duke paditur tre gjyqtarë, ku ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit, me objekt *“dëmshpërblim i dëmit jopasuror”*. Ai pretendon se subjekti gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar në datën 12.9.2017 ka fyer rëndë nderin dhe personalitetin e paditësit G.Y, duke i cenuar personalitetin dhe integritetin psikik dhe, për këto arsye, ka kërkuar edhe përjashtimin e subjektit nga gjykimi i çështjes civile nr. *** të vitit 2017.

b. Gjithashtu, denoncuesi nëpërmjet kërkesëpadisë nr. *** të vitit 2018 ka kërkuar edhe detyrimin e palës së paditur, znj. Arta Llazari, për ta dëmshpërblyer për dëmin⁹⁸ jopasuror të shkaktuar për shkak të fyerjes, shpifjes dhe diskriminimit.

c. Komisioni ka kërkuar⁹⁹ kopje të dosjes gjyqësore me nr. akti *** të vitit 2017, të shoqëruar me regjistrimin audio në formatin CD, për të verifikuar dëgjuesën e zhvillimit të seancës së datës 12.9.2017, në të cilën denoncuesi pretendon se është fyer nga subjekti.

ç. Komisioni, nga verifikimi i akteve në dosjen e administruar dhe dëgjimi i regjistrimit audio në formatin CD, konstatoi se gjatë zhvillimit të seancës përgatitore në datën 12.9.2017 duket subjekti i rivlerësimit e ka pyetur shtetasin G.Y *“se me çfarë provonte që nuk e kanë ekzekutuar detyrimin”*. Denoncuesi, sipas çmuarjes së tij, shprehet se kjo pyetje e bërë nga subjekti vinte në kundërshtim me nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile, pasi gjykata nuk mund ta ngarkonte me barrën e provës për ekzekutimin apo jo të detyrimit nga ana e palës debitore, pasi kjo gjë i takonte palës së paditur (O sh.a.).

d. Më tej, ai pretendon se kur i është përgjigjur pyetjes së gjykatës (subjektit) se sa ishte shpërblimi që kërkonte nga pala e paditur në rast të zgjidhjes së çështjes me pajtim, ka thënë se *“e di gjykata se sa është masa e dëmshpërblimit, por fundja edhe 10 lekë të vjetër, por pala e paditur duhet të paguajë edhe shpenzimet gjyqësore për avokat që kam bërë”*. Po sipas dëgjuesës së CD-së rezulton se subjekti i rivlerësimit në këtë moment ka reaguar me fjalët *“mos m'i bëj këto lojëra”*, *“mos m'i bëj këto në sallën time”*, si dhe ka përdorur shprehjet *“ty të është ekzekutuar detyrimi që ka pasur pala e paditur, pasi t'i kanë kaluar lekët në bankë dhe nuk e di se çfarë kërkon”*.

dh. Nisur nga këto shprehje, denoncuesi ka pretenduar se gjyqtarja ka mbajtur qëndrim të njëanshëm, si dhe e ka fyer atë, duke ngritur edhe padi gjyqësore lidhur me këtë fakt.

⁹⁶ Nr. *** prot., datë 24.11.2017.

⁹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 1.4.2019.

⁹⁸Duke iu referuar çështjes me nr. akti *** të vitit 2017; me nr. akti *** të vitit 2017; me nr. akti *** të vitit 2017.

⁹⁹Shkresë nr. *** prot., 26.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.11.2022.

e. Komisioni, nisur nga fakti se ky denoncues ka paditur edhe dy subjekte të tjera rivlerësimi, aksesoi vendimet¹⁰⁰ e tij/Komisionit lidhur me këtë fakt, ku konstatoi se kjo çështje është trajtuar edhe në këto raste. Në këto vendime merret informacion se padia e denoncuesit është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër si e pabazuar në prova dhe ligj, ndërsa paditësi ka preferuar të heqë dorë, duke u pushuar gjykimi përpara dhënies së vendimit përfundimtar. Gjithashtu, Komisioni¹⁰¹ i kërkoi edhe subjektit të rivlerësimit informacion lidhur me këtë padi të shtetasit G.Y ndaj saj, për të cilën subjekti depozitoi shkresën¹⁰² kthim përgjigjeje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

ë. Komisioni, në analizë të të dhënave të dala nga aktet në dosje, por edhe dëgjësës së regjistrimit audio në formatin CD, dhe specifikisht shprehjeve të përdorura nga ana e subjektit, konstaton dhe vlerëson se këto shprehje nuk mund të marrin çmuarje faktiko-ligjore për t'i kualifikuar si joetike për figurën e magjistratit.

f. Gjithashtu, shtetasi G.Y në këtë denoncim pretendonte se në seancën gjyqësore të datës 6.3.2018, që i përket vendimit gjyqësor nr. *** të vitit 2017, subjekti në mënyrë abuzive dhe diskriminuese, pa asnjë shkak të ligjshëm, i ka shtyrë gjykimin denoncuesit, duke caktuar zhvillimin e seancës së radhës në datën 13.4.2018, me arsyetimin se kishte gjykime të tjera. Ai pretendon se subjekti e ka diskriminuar atë në raport me shtetasit e tjerë, duke cituar edhe nenet 18/1 dhe 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

g. Për sa më sipër, Komisioni administroi dosjen¹⁰³ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket vendimit gjyqësor nr. *** të vitit 2017, shoqëruar edhe me regjistrim audio në CD.

gj. Nga verifikimi i akteve në dosjen gjyqësore¹⁰⁴ rezultoi se me shortin e datës 14.9.2017 gjykimi i kësaj çështjeje i ka kaluar për gjykim subjektit të rivlerësimit, e cila ka vijuar gjykimin deri në datën 26.4.2018. Në vijim rezulton se subjekti ka paraqitur kërkesë për dorëheqje drejtuar kryetarit të gjykatës, me arsyetimin se paditësi ka ngritur padi kundër saj dhe kësisoj është në diskutim paanësia e saj në këtë gjykim, e cila është miratuar nga ky i fundit.

h. Komisioni, pas dëgjësës së regjistrimit audio të CD-së për këtë çështje, konstaton se pretendimet e ngritura nga ky denoncues në këtë rast nuk qëndrojnë. Rezulton se gjatë zhvillimit të kësaj seance gjyqësore nga ana e subjektit është ruajtur etika në komunikim edhe kur paditësi ngre tonin e zërit dhe krijon situata sugjestive.

i. Më tej, referuar pretendimit të denoncuesit lidhur me çështjen që i përket vendimit gjyqësor nr. *** të vitit 2017, ku ai pretendon se subjekti e ka diskriminuar duke e trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me shtetasin F.B gjatë gjykimit të kësaj çështjeje gjyqësore, nga verifikimi i akteve në dosje¹⁰⁵ dhe dëgjësës së regjistruar në audio, Komisioni konstatoi se:

j. Çështja gjyqësore nr. *** e vitit 2017, e rishortuar në datën 8.2.2018, i ka kaluar për gjykim subjektit të rivlerësimit, e cila në datën 4.5.2018 ka kërkuar dorëheqjen nga gjykimi për këtë çështje, me arsyetimin se paditësi ka ngritur padi kundër subjektit dhe kësisoj është në diskutim paanësia e saj në këtë gjykim, kërkesë e cila është miratuar nga kryetari i gjykatës.

k. Komisioni lidhur me këtë çështje nga njëra anë konstaton se pretendimi i subjektit për diskriminim nuk pasqyron ndonjë të dhënë konkrete se kujt i referohet dhe, nga ana tjetër, sipas dëgjësës së CD-së, konstaton se nuk evidentohen elemente që mund të lidhen më etikën e subjektit apo të tregojnë të dhëna diskriminuese në raport me shtetasin F.B.

¹⁰⁰Vendimet nr. *** dhe nr. *** të Komisionit.

¹⁰¹Pyetësor nr. 5, datë 4.1.2023.

¹⁰²Shkresë nr. *** prot., datë 6.1.2023, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁰³Shkresë nr. *** prot., 13.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁰⁴Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.12.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁰⁵Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.12.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

34.5 Denoncim¹⁰⁶ i shtetases L.D (bashkim i tre denoncimeve për të njëjtin pretendim dhe nga i njëjti denoncues)

a. Kjo shtetase nëpërmjet këtij denoncimi ankohet për një proces jo të rregullt ligjor dhe zvarritjen e gjykimit të çështjes së saj gjyqësore (pasi ajo ka fituar konkursin për pozicionin e punës të shpallur të lirë dhe nuk është punësuar më pas sipas ligjit të sistemit arsimor) nga disa subjekte të tjera (gjyqtarë) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

b. Nëpërmjet këtij denoncimi, ajo pretendon se gjyqtarja e çështjes V.D e ka kthyer padinë për plotësim të metash, pasi ka realizuar seancën përgatitore, ka vazhduar me procedurën e mbledhjes së provave dhe pas 4 seancash kjo gjyqtare ka vendosur mospranimin e padisë, duke dhënë edhe argumentet përkatëse, ku ndër të tjera parashton faktin se çështja gjyqësore nuk është administrative, por civile, me argumentin se konfliktet e punës zgjidhen me Kodin e Punës.

c. Më pas, denoncuesja ka ngritur një padi civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe me short është përcaktuar subjekti i rivlerësimit Arta Llazari. Më tej denoncuesja e ka tërhequr padinë dhe ka ngritur një padi të re, ku përcaktohet po e njëjta gjyqtare, e cila më pas ka hequr dorë nga gjykimi (kërkesë që i është pranuar nga kryetari i gjykatës).

ç. Në vijim, padia është rihedhur në short dhe çështja i ka kaluar për gjykim një gjyqtari tjetër (A.Y), i cili ka shpallur moskompetencën, duke arsyetuar se çështja është administrative dhe jo civile. Më pas, çështja kalon në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe me short përcaktohet që të gjykohej nga gjyqtari G.M, i cili ka vendosur të pushojë çështjen gjyqësore, me pretendimin se çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë (me kërkesë të palës së paditur).

d. Në vijim, denoncuesja pretendon se padia lidhur me çështjen në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë ishte e ndryshme nga padia në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, pasi paraqiteshin prova të reja dhe palë e re e paditur Komisioni i Vlerësimit.

Nga hetimi i akteve bashkëlidhur këtij denoncimi nuk evidentohet nëse denoncuesja ka bërë ankim ndaj këtij vendimi, pasi nuk ka depozituar kopje të tij.

dh. Në rastin e këtij denoncimi, subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes me kërkesë pranë kryetarit të gjykatës, i cili e ka aprovuar atë. Denoncuesja i është drejtuar Komisionit për gjyqtaren V.D, me pretendimin se pas 4 muajsh kjo gjyqtare ka ndërprerë procesin e shqyrtimit të çështjes së saj, duke shpallur mospranim të saj, duke e ndërprerë në mes procesin dhe duke e ndryshuar krejtësisht drejtimin e gjykimit të çështjes.

e. Komisioni, nga verifikimi i akteve në dosje dhe të dhënat e dala prej tyre, në raport me pretendimet e denoncuesit, konstaton se duket se ato janë të lidhura me subjekte të tjera rivlerësimi, si dhe nuk evidenton fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34.6 Denoncim¹⁰⁷ i shtetasit N.M (bashkim i dy denoncimeve të njëjta në pretendim dhe nga i njëjti denoncues)

a. Denoncuesi ngre pretendimin se vendimi i rrëzimit të padisë për çështjen gjyqësore me objekt “kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të shoqërisë përmbarimore ‘G. D. C’ sh.p.k.” nga ana e subjektit të rivlerësimit, është e pabazuar në ligj e në prova. Gjithashtu, ky denoncues ka paraqitur edhe kallëzim penal për subjektin, nëpërmjet të cilit kërkon regjistrimin

¹⁰⁶ Nr. *** prot., datë 25.3.2019; nr.*** prot., datë 10.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 15.11.2021.

¹⁰⁷ Me kërkesë nr. *** prot., datë 11.3.2020 dhe denoncim me kërkesë nr. *** prot., datë 11.9.2020.

e procedimit penal dhe të fillojnë hetimet për këtë subjekt, për veprën penale “shpërdorim detyre”, referuar nenit 248 të Kodit Penal.

b. Komisioni, nga verifikimi i vendimit të subjektit, konstaton se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata¹⁰⁸ e Apelit Shkodër.

c. Lidhur me kallëzimin penal, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur në datën 26.5.2020 mosfillim procedimi. Komisioni ka pyetur¹⁰⁹ subjektin për statusin e tij dhe në përgjigje ka depozituar vendimin nr. ***, datë 30.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. *** të vitit 2020. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.2.2021.

ç. Komisioni lidhur me pretendimet e denoncuesit konstaton se ato kanë të bëjnë me themelin e çështjes, ndërsa lidhur me pretendimin e tij për regjistrimin e procedimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit vlerëson se ky pretendim nuk mund t'i adresohet Komisionit.

34.7 Denoncim¹¹⁰ i shtetasit D.P

Denoncuesi në këtë denoncim ankohet në tërësi për subjekte të tjera, gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që kanë gjykuar ndër vite disa çështje gjyqësore civile me objekt pronësie që lidhen me të, por nuk shpreh ankesë apo ndonjë pretendim në lidhje me subjektin e rivlerësimit, pasi nuk ka qenë pjesë në vendimmarrje në ndonjë vendim gjyqësor të dhënë që lidhet me denoncuesin. Përkundrazi, në këtë denoncim ai shpreh vlerësim, duke e konsideruar subjektin si një njeri të ndershëm dhe me një përkushtim profesional të admirueshëm.

34.8 Denoncim¹¹¹ i shtetasit A.B

a. Në këtë denoncim, ky shtetas ngre pretendime në lidhje me prokurorë dhe gjyqtarë, të cilët i akuzon për shpërdorim detyre, ku ndërmjet tyre përmendet edhe subjekti i rivlerësimit. Në këtë pretendim, ai parashtron çështjen e tij gjyqësore lidhur me një konflikt pronësie, ku për të njëjtën pasuri me sipërfaqe 20.700 m², të llojit “arë”, të ndodhur në fshatin K të Malësisë së Madhe, ka dy tituj pronësie për të njëjtën pronë të lëshuar nga dy institucione publike titulldhënëse. Denoncuesi kërkon pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2019 për falsifikim dokumentesh, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë çështje ka vendosur se deri në zgjidhjen e çështjes penale me objekt “falsifikim dokumentesh”, duhet bërë pezullimi civil i gjykimit të çështjes deri në përfundimin e hetimit penal të paraqitur nga kallëzuesi penal.

b. Pas verifikimit të pretendimeve të denoncuesit, Komisioni konstatoi se nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34.9 Denoncim¹¹² i shoqërisë “I.C Albania” sh.a., përfaqësuar me prokurë nga shoqëria “A” sh.p.k. (bashkim i pesë denoncimeve me tipologji të njëjtë problematike)

a. Rezulton se denoncuesi ngre pretendimin se ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër një numër të lartë kërkesash për lëshim urdhër ekzekutimi lidhur me kontratat e kredisë së këtij institucioni financiar, që janë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka dalë me vendim për kthimin e këtyre kërkesave. Denoncuesi pretendon se vendimet e dhëna nga gjyqtarja Arta Llazari janë të padrejta, duke sjellë si pasojë dhe cenimin e rëndë të të drejtave themelore të parimit të zhvillimit të një gjykimi të paanshëm, pasi ka shmangur një hetim të

¹⁰⁸Me vendimin nr. ***, datë 17.9.2018.

¹⁰⁹Pyetësor nr. 5, datë 4.1.2023.

¹¹⁰ Me kërkesë nr. *** prot., datë 14.8.2020.

¹¹¹ Me kërkesë nr. 1*** prot., datë 23.2.2020.

¹¹²Denoncim me kërkesë nr. *** prot., datë 6.4.2021; denoncim me kërkesë nr. *** prot., datë 7.4.2021; denoncim me kërkesë nr. *** prot., datë 7.4.2021; denoncim me kërkesë nr. *** prot., datë 7.4.2021; denoncim me kërkesë nr.*** prot., datë 23.4.2021.

plotë e të gjithanshëm. Në këtë mënyrë, shprehet denoncuesi, gjendemi përballë paragjyimit për këtë gjyqtare, pasi ka kthyer çdo kërkesë të ngritur nga shoqëria “I.C Albania”, sh.a. Gjithashtu, ky denoncues kërkon nga Komisioni nisjen e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit. Këtyre ankesave denoncuesi i ka bashkëlidhur disa vendime¹¹³ gjyqësore.

b. Rezulton se në të gjitha ankesat/denoncimet e depozituara nga ky denoncues konstatohet se ato kanë të njëjtën tipologji problematike dhe të njëjtin objekt, “lëshim urdhër ekzekutimi lidhur me kontratat e kredisë së këtij institucioni financiar”.

c. Nga verifikimi i vendimeve gjyqësore të depozituara nga denoncuesi konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur kthimin e akteve të paraqitura nga kërkuësja “I.C Albania” sh.a. me të meta, duke i konsideruar ato si të paraqitura. Në vendimet e saj, subjekti lidhur me kthimin e këtyre akteve ka arsytuar se: (i) në aktet e paraqitura nga kërkuësja nuk rezultojnë të jenë paraqitur akte që provojnë lëvrimin e shumës së dhënë hua huamarrësit; (ii) kërkuësja nuk ka provuar disbursimin e huas në favor të debitorit, duke treguar dhe konfirmuar se ky debitor me të vërtetë e ka marrë këtë shumë; (iii) nuk rezulton të ketë akte për njoftimin e debitorit sipas nenit 9 të kontratës “kushtet e përgjithshme”. Vërehet se gjykata gjithashtu i ka tërhequr vëmendjen kërkuëses që të marrë parasysh edhe mundësinë e gjobitjes për paraqitjen në mënyrë të përsëritur të këtij veprimi abuziv, me po të njëjtat të meta të paraqitura referuar nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

ç. Në përfundim, Komisioni, nga verifikimi i vendimeve gjyqësore në raport me pretendimet e denoncuesit, nuk evidenton shkelje procedurale që mund të ndikojnë në kriterin profesional të subjektit. Po ashtu, lidhur me pretendimin e denoncuesit për nisjen e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se ky pretendim, bazuar në ligjin nr. 84/2016, është jashtë kompetencës së Komisionit.

34.10 Denoncim¹¹⁴ i shoqërisë “F” sh.p.k. Konstatohet se ky denoncim është përsëritur 7 herë. Duket se është i njëjtë në tipologji me denoncimin e sipërcituar, si dhe të ndërvarur me njëri-tjetrin.

a. Rezulton se denoncuesi, shoqëria “F” sh.p.k. ka ngritur pretendimin nëpërmjet këtij denoncimi se ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër një numër të lartë kërkesash për lëshim urdhërekzekutimi lidhur me kontratat e kredisë të këtij institucioni financiar, që janë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka dalë me vendim për kthimin e këtyre kërkesave. Denoncuesi pretendon se vendimet e dhëna nga gjyqtarja Arta Llazari janë të padrejta, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e rëndë të të drejtave themelore të parimit të zhvillimit të një gjykimi të paanshëm, duke shmangur një hetim të plotë e të gjithanshëm. Në këtë mënyrë, shprehet denoncuesi, gjendemi përballë paragjyimit për këtë gjyqtare, pasi ka kthyer çdo kërkesë të ngritur nga shoqëria “F” sh.p.k. Për të gjitha rastet e përshkruara dhe pretenduara më lart nga denoncuesi, kërkon gjithashtu nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarës Arta Llazari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Bashkëlidhur këtyre ankesave, denoncuesi ka bashkëlidhur disa vendime gjyqësore¹¹⁵ me të njëjtin objekt.

¹¹³Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 22.1.2021; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 28.1.2021; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 18.1.2021; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 13.4.2021; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 12.2.2021.

¹¹⁴ Nr. ***, datë 8.4.2021; nr. *** prot., datë 8.4.2021; nr. *** prot., datë 8.4.2021; nr. *** prot., datë 8.4.2021; nr. *** prot., datë 23.4.2021; nr. *** prot., datë 23.4.2021 dhe denoncim nr. *** prot., datë 23.4.2021.

¹¹⁵(1) Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 2.3.2021; (2) ankim që shoqëria “I.C Albania” sh.a. ka bërë ndaj vendimit të kësaj gjykate pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, datë 3.2.2021; (3) ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri aksionere”; (4) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 17.3.2021; (5) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 17.3.2021; (6) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 17.3.2021; (7) ankim që shoqëria “F” sh.p.k. (institucion financiar jobankar) ka bërë ndaj vendimit të kësaj gjykate pranë Gjykatës së Apelit Shkodër; (8) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 6.4.2021; (9) ankim që

b. Nga verifikimi i vendimeve gjyqësore konstatohet se ato kanë të njëjtën tipologji problematike dhe me të njëjtin objekt, “lëshim urdhër ekzekutimi lidhur me kontratat e kredisë të këtij institucioni financiar”.

c. Subjekti mbi këto kërkesa ka vendosur kthimin e akteve të paraqitura nga kërkuesi “F” sh.p.k., me të meta sipas nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, duke i konsideruar ato si të paparaqitura. Në vendimet e saj, subjekti lidhur me kthimin e këtyre akteve ka arsyetuar mbi të metat e akteve, si dhe ndërlidhjen e tyre me subjektin “I.C Albania” sh.a., duke i vlerësuar këto kërkesa si abuzive dhe, në këtë rast, duke e gjobitur sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile. Konstatohet se subjekti në vendimin e saj i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, vendimit nr. ***, datë 3.6.2020.

ç. Komisioni, nga verifikimi i vendimeve gjyqësore, në raport me pretendimet e denoncuesit, vlerësoi se nuk evidentohen shkelje procedurale. Po ashtu, lidhur me pretendimin e denoncuesit për nisjen e procedimit disiplinor, ndaj subjektit të rivlerësimit konstaton se ky pretendim, bazuar në ligjin nr. 84/2016, është jashtë kompetencës së Komisionit.

34.11 Denoncim¹¹⁶ i shtetasit S.K

a. Denoncuesi ankohet pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar zvarritjen dhe moszbardhjen prej 4 muajsh të vendimit gjyqësor të dhënë prej saj në datën 22.12.2020. Ky shtetas lidhur me këtë çështje gjyqësore, me objekt “kundërshtimin e veprimeve përmbarimore”, pretendon gjithashtu se kjo gjyqtare ka dhënë një vendim të njëanshëm, të padrejtë dhe të pabazuar në prova dhe ligjin procedural. Nga analizimi i fakteve të parashtruara nga denoncuesi, Komisioni vëren se në datën 24.12.2019 ky i fundit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me çështjen civile, me objekt “kundërshtimin e veprimeve përmbarimore”, gjykuar nga gjyqtarja I.K, e cila në datën 16.1.2020 ka vendosur anulimin e vendimit nr. *** prot., datë 11.12.2019, të Zyrës Përmbarimore Shkodër. Zyra Përmbarimore në datën 13.2.2020 ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 16.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe e ka dërguar për rigjykim pranë kësaj gjykate me një tjetër trup gjykues, për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimit të gjykatës, i cili nuk është firmosur nga gjyqtarja e çështjes në kundërshtim me nenin 308/1 të Kodit të Procedurës Civile. Në datën 20.7.2020 kjo çështje gjyqësore është regjistruar për t’u gjykuar përsëri me një trup tjetër nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

b. Nga verifikimi i të dhënave në vendimin gjyqësor, Komisionit i rezultoi se kjo çështje gjyqësore është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë 2-mujore, 26.10.2020 - 22.12.2020. Ky vendim gjyqësor, referuar edhe parashtrimeve të denoncuesit në ankesë, nuk është zbardhur si vendim prej 4 muajsh dhe nuk është dërguar në sekretarinë gjyqësore në zbatim të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile.

c. Komisioni, lidhur me pretendimet e denoncuesit dhe specifikisht për zvarritjet e kësaj çështjeje gjyqësore dhe vonesat në zbardhjen e vendimit gjyqësor, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit Arta Llazari.

ç. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar disa rrethana për të provuar vonesën në zbardhjen e vendimit gjyqësor. Më konkretisht, subjekti ka theksuar se: (i) në fund të tetorit 2020 ka kaluar COVID-19 së bashku me prindërit e saj dhe se deri në muajin prill ka pasur probleme shëndetësore të rënda me plagë e dëmtime në duar e këmbë, diagnozë e cila është përcaktuar

shoqëria “F” sh.p.k (institucion financiar jobankar) ka bërë ndaj vendimit të kësaj gjykate pranë Gjykatës së Apelit Shkodër; (10) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 6.4.2021; (11) ankim që shoqëria “F” sh.p.k. (institucion financiar jobankar) ka bërë ndaj vendimit të kësaj gjykate pranë Gjykatës së Apelit Shkodër; (12) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. ***, datë 13.4.2021.

¹¹⁶ Nr. ***, datë 29.4.2021.

vetëm në prill 2020; (ii) për këto shkaqe ka pasur rënie të rendimentit në punë, pasi nuk mundësohej shtypja e butonave të tastierës së kompjuterit dhe vendosja e duarve normalisht, pa dhimbje dhe djegie, në çfarëdo fashikulli gjyqësor; (iii) ka kërkuar më tej edhe leje të papaguar nga KLGJ-ja (sipas nenit 24 të ligjit nr. 96/2016), e cila i është miratuar me vendimin nr. ***, datë 9.6.2021.

d. Trupi gjykues vlerësoi të marrë në konsideratë sqarimet e subjektit pasi duken bindëse dhe në logjikën e një vijueshmërie të ushtrimit të detyrës në mënyrë të kushtëzuar dhe të paqëllimshme. Problematika shëndetësore e parashtruar ka qenë dhe mbetet një fakt i njohur botërisht, i shoqëruar gjithashtu me pasoja. Në të tilla kushte, nuk vlerësohen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

34.12 Denoncim¹¹⁷ i shtetasit M. SH

a. Rezulton se ky denoncues ngre pretendime për zvarritje dhe afat të tejzgjatur në lidhje me shqyrtimin e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 30.7.2021, nga subjekti i rivlerësimit. Sipas denoncuesit, ankimi i tij për këtë vendim gjyqësor civil nuk lidhet me vendimmarrjen e gjyqtarës Arta Llazari, pasi ligjshmëria e gjykimit të kësaj çështjeje në themel do të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit Shkodër, por nëpërmjet kësaj ankese kërkon të merret në shqyrtim afati i tejzgjatur i gjykimit të çështjes, shtyrja e seancave gjyqësore të kërkuara nga pala e paditur pa asnjë provë dhe shkak ligjor, që kanë shkaktuar zvarritje të gjykimit të çështjes. Denoncuesi thekson se kjo çështje për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka zgjatur 4 vjet rresht. Denoncuesi i ka bashkëlidhur këtij denoncimi edhe një kopje të vendimit gjyqësor me nr. ***, datë 30.7.2021.

b. Komisioni nga verifikimet e kryera konstaton se ky vendim është regjistruar në gjykatë në datën 16.11.2017 dhe ka përfunduar në datën 30.7.2021, duke kaluar afatet ligjore të gjykimit të kësaj çështjeje civile.

c. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me tejkalimin e afateve të gjykimit të kësaj çështjeje¹¹⁸, si dhe pretendimet e denoncuesit për shtyrjen e seancave gjyqësore të kërkuara nga pala e paditur pa asnjë provë dhe shkak ligjor, që kanë shkaktuar zvarritje të gjykimit të çështjes.

ç. Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit dhe, për të mbështetur shpjegimin e saj, ka depozituar një tabelë me përshkrimet përkatëse mbi zhvillimin e të gjitha seancave të këtij gjykimi dhe shkaqet e shtyrjes së tyre. Subjekti ka sqaruar se si gjyqtare, në respektim të parimit për respektimin e kontradiktoritetit, i ka dhënë mundësinë çdo pale të mbrojë të drejtat që pretendonte në atë gjykim. Ajo ka theksuar se konflikti konkret ka qenë shumë i ndërlikuar, ndërlikim që e kishin bërë si pala paditëse, ashtu edhe institucioni i ASHK-së. Subjekti ka qartësuar se në këto rrethana nuk e ka vlerësuar si të tepërt kërkesën e secilës prej palëve për ta shtyrë seancën edhe kur nuk kanë pasur të pranishëm mbrojtësit e tyre etj.

d. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna, verifikimit të tabelës së përgatitur nga subjekti e cila rezultoi e njëjtë me dokumentacionin (procesverbalet e shtyrjes së seancave gjyqësore) e dosjes gjyqësore të depozituar nga subjekti, konstatoi se në të vërtetë çështja ka qenë komplekse, janë shtyrë seanca për plotësimin e të metave të padisë, për vendosje të vlerës së padisë, për të njoftuar në mënyrë të përsëritur palën shtet, janë shtyrë seanca për thirrje eksperti, për depozitim të aktekspertizës, për shtesa pyetjesh në aktin e ekspertizës, për arsye shëndetësore të palëve ndërgjyqëse në mënyrë reciproke, si dhe për shkak të lejes së papaguar që ka marrë subjekti nga KLGJ-ja për arsye shëndetësore e familjare.

¹¹⁷ Nr. *** prot., datë 7.4.2022.

¹¹⁸ Sipas vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve".

- a) veprimet e atribuuara të personit të dyshuar nga organi i akuzës nuk përmbajnë elemente objektive dhe subjektive që i përkasin kësaj vepre penale;
- b) objekt material i kësaj figure penale janë materialet identifikuese, listat e votuesve, fletët e votimit apo dhe vetë zgjedhësi, si dhe, në rast se është subjekt i posaçëm, shkel në atë mënyrë rregullat e votimit, sa si rezultat ka mospasjen mundësi të votuesit të votojë lirshëm dhe sipas vullnetit të tij të lirë, ku faktikisht sipas subjektit i dyshuari nuk ka kryer ndonjë nga këto veprime konkrete materiale;
- c) subjekti arsyeton se i dyshuari nuk ka kryer ndonjë veprim konkret të paligjshëm për kryerjen e kësaj vepre penale, duke vlerësuar se ndalimi i tij nuk është veprim i ligjshëm, pasi neni 253 i Kodit të Procedurës Penale kërkon domosdoshmërisht pasjen e një vepre penale në formën e krimit.

35.1.iv Në lidhje me caktimin apo jo të ndonjë mase sigurimi ndaj personit të dyshuar, subjekti ka argumentuar se, për sa kohë nuk ka ndonjë element të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 330 i Kodit Penal, atëherë nuk mund të vendoset ndonjë masë sigurimi personal shtrëngues.

35.2 Për arsyet e përshkruara më lart, subjekti ka vendosur: Vleftësimin e paligjshëm të ndalimit të të dyshuarit E.SH dhe moscaktimin ndaj këtij të dyshuari të ndonjë mase sigurimi personal shtrëngues. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku kjo e fundit me vendimin nr. ***, datë 15.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

35.3 Komisioni, pas analizimit të akteve në dosje, konstatoi se në këtë çështje nuk evidentohen shkelje konkrete procedurale apo mangësi në arsyetimin e vendimit nga subjekti, të cilat mund të kualifikoheshin si mangësi në aftësitë profesionale të subjektit. Në tërësi për këtë çështje nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

35.4 Trupi gjykues, pas analizimit të denoncimeve të depozituara, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpjegimeve të subjektit bazuar në legjislacion, vlerëson se në tërësi nuk konstatohen problematika që ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit në aspektin e tij profesional.

36. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale¹²¹, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konstaton se gjatë vlerësimit të aftësive etiko-profesionale ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan elemente që ta identifikonin atë me të meta apo probleme në gjykimin e rasteve të tjera individuale, të tilla si mosrespektimi i afateve ligjore, referenca të gabuara ligjore, dosje të paplota apo të tjera në drejtim të cenimit të indikatorëve vlerësues sipas ligjit nr. 76/2016.

36.1 Në këtë drejtim, mangësitë e evidentuara në vendimin gjyqësor të subjektit të rivlerësimit nr. ***, datë 30.7.2021, si dhe çështjen gjyqësore nr. ***, datë 25.10.2018, trupi gjykues i vlerëson të pamjaftueshme për t’i çmuar ato si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e saj

¹²¹Referuar nenit E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; neni 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale” (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias); neni 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë,

apo për ta identifikuar si një magjistrate e cila ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e saj.

36.2 Sa më sipër, trupi gjykues çmoi që mangësitë e konstatuara në çështjet e sipërcituara mund të vlerësohen nga organi kompetent ILD sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, duke i transferuar pranë tij për inspektim të mëtejshëm.

37. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas propozimit të relatores së çështjes, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të gurmës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “e aftë”.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çmon se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.
- b. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arta Llazari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Transferimin e çështjes që i korrespondon vendimit gjyqësor të subjektit të rivlerësimit, nr. *** datë 30.7.2021, si dhe çështjes gjyqësore nr. ***, datë 25.10.2018, pranë organit kompetent, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka